



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 481 Akti

Nr. 452 Vendimi
Tiranë, më 24.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 22.9.2021, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Semiramis Hoxholli**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të **Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli do të shqyrtohet nga trupi gjykues, i cili përbëhet nga komisionerët Alma Faskaj relatores, Etleda Çiftja kryesuese dhe Suela Zhegu anëtare.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Semiramis Hoxholli, duke krahasuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jobankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, për subjektin e rivlerësimit Semiramis Hoxholli, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

4.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 31.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Semiramis Xh. Hoxholli (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 5.2.2021, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Semiramis Xh. Hoxholli.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 20.6.2020, të trupit gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionere Etleda Çiftja. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

7. Në datën 22.11.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin në datën 7.12.2020 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Gjithashtu, subjekti depozitoi një kërkesë paraprake me objekt mosfillimin e procedurës së rivlerësimit për të, administruar në Komision me nr. *** prot., datë 7.12.2020.

8. Në kërkesën e saj, subjekti i rivlerësimit parashtroi, ndër të tjera, se: *“Në ligjin nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’ janë përcaktuar rregullat e posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit. Në pikën 16, të nenit 3, të këtij ligji është parashikuar se: ‘Subjekt i rivlerësimit janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës’. Në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë janë konsideruar subjekt rivlerësimi ‘të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë’, të cilët i nënshtrohen vlerësimit ex officio.*

*Ligji nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’ është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.9.2016 dhe ka hyrë në fuqi më 8.10.2016. Subjekt i këtij ligji janë të gjithë personat e emëruar ‘gjyqtar’ deri më 8.10.2016. Ashtu sikurse parashtrova më sipër, unë jam emëruar ‘magjistrate’, me vendimin nr. 3, datë 20.1.2017 dhe jam caktuar në pozicion me vendimin nr. ***, datë 10.2.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në datën kur ligji nr. 84/2016 ka hyrë në fuqi, unë nuk e kam pasur titullin ‘gjyqtare’, kjo referuar edhe vetë nenit 160 të ligjit nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve’, i cili na ka cilësuar në mënyrë të shprehur ‘kandidat për magjistratë të diplomuar në vitin 2016’ dhe jo gjyqtarë në detyrë. Theksoj se ky rregullim ligjor ka qenë specifik, vetëm për brezin e magjistratëve që kanë kryer Shkollën e Magjistraturës në periudhën tetor 2013 – qershor 2016.*

Kur jam emëruar në detyrën e gjyqtarës janë aplikuar të gjitha kriteret, të cilat duhet të aplikohen për çdo gjyqtar të ri, i cili ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të periudhës korrik - tetor 2016. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vepruar në cilësinë e organit suksedor të të drejtave dhe detyrimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me kompetencat e plota të këtij të fundit, në atë kohë ende të pa krijuar.

Në lidhje me periudhën e rivlerësimit profesional, i njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i cili në vendimmarrjet e tij ka cilësuar si periudhë rivlerësimi profesional, periudhën 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016 dhe jo më vonë kësaj date (konkretisht vendimi nr. 85, datë 13.12.2018, faqe 9; vendimi 117, datë 21.3.2019, faqe 14; vendimi nr. 57, datë 1.8.2018, faqe 17; vendimi nr. 19, datë 14.5.2018, faqe 10; vendimi nr. 20, datë 4.6.2018, faqe 15; vendimi nr. 26, datë 21.6.2018, faqe 16; vendimi nr. 27, datë 25.6.2018, faqe 11; vendimi nr. 56, datë 1.8.2018, faqe 28; vendimi nr. 54, datë 31.7.2018, faqe 13 etj.). Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe unë nuk kam dhënë as vendime meritore dhe jomeritorike gjyqësore, pasi nuk kam qenë e emëruar si gjyqtare dhe do të ishte në pamundësi totale, të paktën, për t’u vlerësuar në kriterin e ‘aftësive profesionale’.

Nëse nuk do të ishte zbatuar ligji nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve’, atëherë nuk do të ishte i mundur caktimi në pozicion në Gjykatat Administrative, pasi asnjë

prej personave që janë emëruar nuk plotësonte kriterin e caktuar në pikën 2, të nenit 5, të ligjit nr. 49/2012 (5 vjet vjetërsi).

Në dispozitat kalimtare të ligjit nr. 96/2016, në nenin 160, në të cilin është parashikuar procedura që duhej të ndiqej nga KLD-ja për emërimin si 'Magjistrat' dhe 'Caktimin në pozicion', nuk është parashikuar si shkak i mbarimit të statusit rezultati i procesit të rivlerësimit (duke u përjashtuar zbatimi i ligjit nr. 84/2016). Ky parashikim ligjor është i qartë dhe i ndryshëm nga dispozitat kalimtare të tjera, ku janë rregulluar në mënyrë specifike disa nga subjektet e tjera si anëtarët e gjykatës së lartë, Prokurori i Përgjithshëm, etj.

Marrja në shqyrtim dhe kryerja sërish e procedurës, për marrjen e titullit 'magjistrat', që parashikohet në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve' do të cenonte parimin e 'sigurisë juridike' dhe parimin 'gjë e gjykuar'".

9. Trupi gjykues e njoftoi subjektin me anë të postës elektronike se ka vendosur që subjekti i rivlerësimit duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe lidhur me këtë vendim mund të ushtrohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar, duke arsyetuar se:

Së pari, qëllimi i procesit të rivlerësimit nuk është të emërojë apo caktojë një magjistrat në detyrë, por të kryejë rivlerësimin kalimtar sipas Kushtetutës dhe ligjit për konfirmimin ose jo të tij në atë funksion.

Së dyti, parimet mbi të cilat zhvillohet ky proces parashikohen shprehimisht në Kushtetutë dhe jurisprudenca së cilës i referohet subjekti për përjashtimin nga procesi i rivlerësimit, nuk cenon parimin e sigurisë juridike dhe atë të gjësë së gjykuar, i njeh të drejtat themelore të individit (jo ndaj zyrtarëve të lartë të shtetit apo funksionarëve të sistemit të drejtësisë).

Së treti, kufizimi i disa të drejtave për gjyqtarët dhe prokurorët sipas Kushtetutës dhe Aneksit të saj ka për qëllim krijimin e besimit të publikut te drejtësia dhe institucionet e reja të sistemit dhe ky qëllim realizohet përmes zbatimit drejtpërdrejt të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nga institucionet e rivlerësimit dhe jo nga institucionet e emërtesës.

Organet e emërtesës, sipas ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së", të ndryshuar, nuk mund të bëjnë rivlerësimin e subjektit, por vetëm verifikimin për efekt të procedurës së parashikuar nga rregullat e ligjit të ri nr. 96/2016. Pretendimi se subjekti është verifikuar nga organet kompetente sipas ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, të ndryshuar, dhe nenit 160 të ligjit nr. 96/2016, nuk do të thotë se është rivlerësuar. Kjo do të përbënte cenim të juridiksionit të institucioneve të rivlerësimit dhe tejkalim të parashikimeve kushtetuese nga organet e tjera.

Së katërti, Kushtetuta nuk ka parashikuar një rregullim të veçantë apo përjashtim të shprehur nga procesi i rivlerësimit, përkundrazi e lidh qëndrimin e mëtejshëm në detyrë, nëse kalohet me sukses procesi i rivlerësimit. Për pasojë, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta tejkalojë asnjë ligj apo organ tjetër. Kushtetuta njeh institucionet e rivlerësimit dhe përcakton juridiksionin e tyre për zbatimin e procedurave të rivlerësimit ndaj subjekteve *ex officio* ose me kërkesë. Komisioni nuk emëron magjistratë, pasi është tagër dhe juridiksion i organeve kushtetuese të emërtesës, që parashikohen në ligjin themeltar dhe në ligjin organik të tyre.

Ligjet që janë miratuar pas ndryshimeve të Kushtetutës, nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016, janë në zbatim dhe në frymën e Kushtetutës dhe juridiksioni i organeve kushtetuese duhet të jetë brenda kufijve që vetë Kushtetuta përcakton për institucionet e rivlerësimit dhe për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP dhe ILD), përfshirë dhe ato kompetenca të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për periudhën tranzitore.

Së pesti, arsyeja pse ligji nr. 96/2016 bën përjashtim për subjektet magjistratë kandidatë të diplomuar në vitin 2016, që emërohen nga ish-KLD, qëndron për faktin se:

- Në pikën 1 të nenit 173 “Shfuqizime”, të ligjit nr. 96/2016, shfuqizohen menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit për statusin disa dispozita të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, të ndryshuar, ndër to edhe neni 28 “Emërimi i gjyqtarëve”.

- Në pikën 2, të nenit 173, të ligjit nr. 96/2016, parashikohet shfuqizimi në tërësi i gjithë ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, të ndryshuar, me ngritjen e institucioneve KLGJ dhe KLP.

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 208, datë 7.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, pra në datën 22.11.2016. Emërimi dhe caktimi i subjektit në detyrën e gjyqtarit është bërë në bazë të procedurave të reja të këtij ligji (96/2016), por organi i emërtesës është ai i ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, i ndryshuar.

- Në dokumentacionin e administruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor rezulton se subjekti ka pasur emërim të përkohshëm si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 13.11.2015, të ish-KLD-së dhe “emërimi i përkohshëm” është një institut, që parashikohet edhe nga ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, i ndryshuar, edhe nga ligji i ri nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Praktika/stazhi si gjyqtar me emërim të përkohshëm, e cila zhvillohet në vitin e tretë të Magjistraturës (vitet 2015-2016), e vendos subjektin në kushtet e ushtrimit të funksionit dhe të qenit në detyrën e gjyqtarit edhe pse me emërim të përkohshëm.

- Për rrjedhojë, automatikisht subjekti është në sferën e zbatimit të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe subjekt i këtij ligji. Ndërkohë që vetë ligji nr. 96/2016, i cili parashikon rregullimet tranzitore në nenet 164 dhe 169 të tij për gjyqtarët dhe prokurorët, në frymën e Kushtetutës dhe në zbatim të drejtpërdrejt të saj dhe të ligjit nr. 84/2016, e lidh qëndrimin e subjektit në detyrë dhe gëzimin e të drejtave dhe detyrimeve të gjyqtarëve me kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar.

10. Në përfundim, trupi gjykues, për sa arsyeton më sipër, vlerëson se znj. Semiramis Hoxholli, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ishte subjekt që duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio*.

11. Në datën 8.9.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Semiramis Hoxholli, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

12. Në datën 9.9.2021, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë brenda datës 17.9.2021.

13. Në datën 13.9.2021, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes dhe më 18.9.2021 dërgoi shpjegimet e saj mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të shoqëruar me dokumentacion.

14. Në datën 20.9.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Semiramis Hoxholli në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike e njoftoi se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 22.9.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

15. Në datën 22.9.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte e pranishme.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Semiramis Hoxholli u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

17. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

18. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Znj. Semiramis Hoxholli ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur, duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

22. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

23. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

24. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

25. Por, referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat

periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

27. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërinë e burimit dhe të krijimit të saj.

28. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës *Vetting*, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Semiramis Hoxholli.

29. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

30. Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2015 - 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

31. Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur) në datën 20.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

32. Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli ka ushtruar këto detyra: (a) tetor 2013 - shtator 2015 ka kryer Shkollën e Magjistraturës; (b) nëntor 2015 - nëntor 2016 ka qenë gjyqtare stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (c) shkurt 2017 e në vijim – gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

33. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

1. Llogari rrjedhëse nr. ***, në “Raiffeisen Bank”. Pjesa takuese: 100%. Gjendja aktuale në llogari sipas vërtetimit (*statement*-it bankar) është 370.32 lekë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: kursimet nga paga si gjyqtare stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (llogari page).

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

1.1 Kjo llogari rrjedhëse është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, vitit 2015, me gjendje në llogari 9.279,57 lekë.

1.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 subjekti ka deklaruar depozitë bankare në “Raiffeisen Bank”, me pjesë në përqindje:100%. Gjendja e llogarisë në datën 1.1.2016 është

279.57 lekë. Në datën 31.12.2016, gjendja është 0 (zero) lekë, me burim krijimi pagën si gjyqtare.

1.3 Nga korrespondenca me bankat¹ rezultoi se në llogarinë e subjektit janë kaluar bursat për ndjekjen e Shkollës së Magjistraturës dhe, më pas, janë transferuar pagat e subjektit të rivlerësimit nga institucionet ku ka kryer detyrën.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ dhe analizës financiare të realizuar, çmon se subjekti ka kryer deklarim të saktë të kësaj pasurie, të krijuar me të ardhura të ligjshme, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Detyrimet e deklaruara në deklaratën Vetting

2. Kontratë qiraje me afat 1-vjeçar për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2017 për një banesë të ndodhur pranë lulishtes “****”, përballë ish-ekspozitës në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Kontrata është lidhur verbalisht, pra, pa formë shkresore, në përputhje me nenin 803/4 të Kodit Civil. Kësti i pagesës së rënë dakord është 6.000 lekë/muaj. Subjekti deklaroi se nuk i ka mbetur asnjë detyrim financiar pa shlyer.

Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

2.1 Në deklaratën e interesave të vitit 2015 (para fillimi të detyrës dhe atë periodike) subjekti ka deklaruar si adresë banimi: lagjja “****”, rruga “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, por nuk ka deklaruar në lidhje me të drejtat që gëzonte mbi këtë pasuri (kontratë qiraje).

2.2 Në deklaratën e interesave private periodike² të viteve 2016 - 2017 ka deklaruar të njëjtën adresë banimi, si dhe kontratën e qirasë, të lidhur verbalisht.

2.3 Rezulton se subjekti, nga momenti i marrjes së detyrës dhe deri në shtator të vitit 2019, ka paguar bashkë me 3 vajza të tjera qiramarrëse 24.000 lekë/muaj (6.000 lekë/secila) dhe nga shtatori i vitit 2019 e në vijim është qiramarrëse e vetme, kundrejt vlerës 24.000 lekë/muaj.

2.4 Subjekti nuk ka paraqitur kontratë formale të lidhur me qiradhënësin, pasi sikurse ka shpjeguar, marrëdhënien e qirasë me qiradhënësin e ka të bazuar në marrëveshje verbale. Sipas deklaramit, kjo marrëveshje është e vlefshme për aq sa parashikon neni 803 i Kodit Civil, ndërkohë, sipas kësaj dispozite, kontrata e qirasë për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë.

2.5 Këtë deklarim të subjektit e ka konfirmuar me deklaratë noteriale edhe një prej bashkëpronarëve të objektit³.

2.6 Komisioni hetoi lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit të subjektit, për shkak të funksionit të saj, me pronarët e objektit të marrë me qira prej saj dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë⁴ dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵ (ku ka qenë gjyqtare stazhiere) konfirmuan që ky subjekt nuk ka shqyrtuar çështje me palë ndërgjyqëse ndonjë prej pronarëve të objektit⁶.

¹Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

²Në vijim të këtij vendimi, DIPP.

³Me prokurë në datën 27.11.2020 një prej bashkëpronarëve, z. H. G., në gjykatën e Landit Linz, Austri, autorizon motrën e tij R. K. për të kryer të gjitha detyrimet e administrimit. Në këtë akt ai deklaroi se në këtë apartament kanë jetuar për 10 vjet 4 persona (znj. Semiramis Hoxholli dhe 4 shtetase të tjera), të cilat kanë paguar nga 6.000 lekë secila dhe që prej muajit shtator të vitit 2019 e në vazhdim qiramarrësja e vetme është znj. Hoxholli, e cila e vetme paguan 24.000 lekë/muaj.

⁴Shkresë nr. ***prot., datë 27.4.2021.

⁵Shkresë nr.*** prot., datë 30.4.2021.

⁶Shkresat nr. *** prot., datë 30.4.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 30.4.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë.

Vlerësimi i Komisionit

Në analizë të provave të administruara, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë lidhur me të drejtën e përdorimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*.

3. Kontratë kredie me kufi (*overdraft*), lidhur në datën 14.12.2016 dhe me vlefshmëri deri më 25.11.2017. Kjo kontratë ka për objekt dhënien e kredisë me kufi *overdraft* deri në shumën 80.000 lekë në llogarinë rrjedhëse bankare, shumë që është akorduar kundrejt kushtit që të kthehet së bashku me interesin e aplikuar mbi balancën debitore TRIBOR 1-vjeçar + 10.1% brenda datës 25.11.2017, në të cilën kontrata përfundon. Shuma e detyrimit që ka mbetur pa shlyer nga kontrata e lidhur është në total 79.941.91 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e një e nëntëdhjetë e një qindarka) lekë.

Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

3.1 Në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar kontratën e kredisë (*overdraft* bankar) me vlerë 80.000 lekë, me datë disbursimi 5.12.2017 dhe ka deklaruar se më vonë ka marrë *overdraft* edhe 30.000 lekë të tjera. Detyrimi në datën 31.12.2017 ka qenë në vlerën 119.606 lekë.

3.2 Subjekti ka përcjellë⁷ me deklaratën *Vetting* kontratën e kredisë *overdraft*, lidhur mes subjektit dhe “Raiffeisen Bank”, në datën 14.12.2016.

3.3 “Raiffeisen⁸ Bank” ka konfirmuar vlerën e *overdraftit* të hapur, i cili është mbyllur në datën 19.3.2019 nga fondet në llogarinë e subjektit, me burim të ardhurat nga paga.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklaram të saktë të këtij detyrimi, të konfirmuar me dokumentacion bankar, në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting*

4. Paga si gjyqtare stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 20.11.2015 – 30.12.2016. Të ardhurat *neto* për këtë periudhë janë në total 1.082.068 lekë.

Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

4.1 Në DIPP-në e vitit 2015 para fillimit të detyrës, subjekti ka deklaruar se si kandidate për gjyqtare pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën tetor 2013 – shtator 2015, është trajtuar me bursë në vlerën 52.000 lekë/muaj.

4.2 Në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar një pagë të marrë në vlerë *neto*, afërsisht 30.000 lekë.

4.3 Në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar të ardhura *neto* nga pagat në vlerën totale 971.748 lekë.

4.4 Deklarimet e subjektit u konfirmuan nga informacioni i përcjellë nga institucionet bankare⁹ dhe nga ISSH-ja¹⁰.

4.5 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka përfituar nga bursa dhe pagat të ardhurat totale si vijojnë:

- viti 2013 – vlerën 87.380 lekë (bursë);
- viti 2014 – vlerën 620.398 lekë (bursë);
- viti 2015 – vlerën 501.197 lekë (bursë + paga);
- viti 2016 – vlerën 971.748 lekë (paga);

⁷Aneks 4/4, dosja e ILDKPKI-së.

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2020, e ISSH-së.

- viti 2017 – vlerën 1.846.618 lekë (paga).

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklaram të saktë të kësaj pasurie, të krijuar me të ardhura të ligjshme, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit¹¹, konstaton se në emër të subjektit të rivlerësimit Semiramis Hoxholli nuk ka asnjë pasuri të paluajtshme të regjistruar dhe as vetëdeklarim të kryer prej saj për ndonjë objekt të ndërtuar pa leje.

GJETJE TË TJERA

5. Transfertë bankare për shtetasin L. Y. Q.

Hetimi i kryer nga Komisioni

5.1 Nga të dhënat e përcjella në Komision nga “Union Bank”¹² rezulton se në datën 24.3.2010 subjekti ka kryer një transfertë bankare drejt llogarisë së z. L. Y. Q. me vlerë 34.000 USD. Kjo shumë është derdhur nga subjekti në arkën e kësaj banke (*cash*) në datën e kryerjes së transfertës. U konstatua se subjekti ka kryer vetëm një herë transfertë drejt llogarisë së z. L. Y. Q., në datën 24.3.2010. Pas kryerjes së transfertës, në datën 31.3.2010, subjekti e ka mbyllur llogarinë bankare me anë të së cilës ka kryer transfertën.

5.2 Subjekti, e pyetur nga Komisioni në lidhje me këtë transfertë me anë të pyetësorit nr. 2, ka dhënë sqarime, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë parashtruar si në vijim: “*Kam ndjekur Shkollën e Magjistraturës në periudhën tetor 2013 – qershor 2016. Me Dekretin e datës 20.11.2015, të Presidentit të Republikës jam caktuar për të kryer praktikën profesionale. Në korrik të vitit 2016 jam diplomuar zyrtarisht pranë Shkollës së Magjistraturës, emërimin përfundimtar në detyrë e kam marrë më 20.1.2017, ndërsa caktimin në pozicionin e gjyqtarës administrative pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e kam marrë më 10.2.2017.*

Ky veprimi im pranë ‘International Commercial Bank’ (ICB Bank Tirana)¹³ është kryer në kohën kur unë nuk ushtroja asnjë funksion publik në sistemin e drejtësisë, prandaj nuk mund të merret në analizë në këndvështrim të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Aneks Kushtetuta merr kuptim vetëm në kuadër të personave që ushtrojnë funksione publike, pra nga momenti i hyrjes në fuqi e për të ardhmen, jo për të shkuarën, ndërsa situata për të cilën ju kërkoni sqarim ka ngjarë 11 vjet më parë. Në këtë kohë unë jo vetëm nuk ushtroja asnjë funksion publik, por kam qenë diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë dhe po ndiqja ciklin Master Shkencor të Nivelit të Dytë, për rrjedhojë unë nuk mbart detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të kësaj vlere të transferuar, për sa kohë që kjo transfertë është bërë në një kohë që nuk kam qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së dhe nuk kam pasur kurrfarë funksioni shtetëror. Megjithatë, duke pasur dëshirën e mirë për bashkëpunim të hapur dhe transparent, deklaroj se transferta në fjalë është bërë për llogari të shtetasit N. M. në kuadër të aktivitetit të tij familjar. Kjo transfertë është bërë në mirëbesim nga ana ime dhe pa kundërshtpërblim. Nuk ka trajtën e ndonjë veprimi juridik dhe nuk ka lidhje me ndonjë aktivitet tregtar timin në shtetin kinez, por është bërë në kuadër të një njohjeje që më pas evoluoi në miqësi me z. N. M. dhe me bashkëshorten e tij. Z. M. ka qenë një ndër pedagogët e mi përgjatë periudhës së studimeve në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku ishte angazhuar si pedagog i jashtëm në leksione të lëndës ‘E drejta penale’ (2008 - 2009). Këtu ka nisur njohja jonë, e cila ka pasur si bazë respektin maksimal që kisha për profesionalizmin dhe vlerat e tij si njeri, por edhe vlerësimin e madh që ai ka pasur për mua si studente e tij. Më vonë ky respekt

¹¹Shkresat: nr*** prot., datë 11.12.2020 dhe nr. *** prot., datë 10.12.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

¹²Shkresë nr*** prot., datë 9.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.12.2020).

¹³Sipas ekstraktit në QKB, “Union Bank” ka përthithur ICB-në në datën 31.7.2019.

dhe kjo njohje evoluoi në një miqësi edhe me të shoqen e tij, znj. M. M., me të cilën u takova për herë të parë gjatë studimeve që po ndiqnim të dyja në ciklin Master Shkencor i Nivelit të Dytë në 'Shkenca Juridike Civile', po pranë FDUT-së. Në një prej bisedave tona, znj. M. më tregoi se ajo me të shoqin kishin një biznes familjar. Ata importonin mallra të ndryshme nga Republika Popullore e Kinës dhe se biznesin e kishin të regjistruar dhe më tha se deri në vitin 2015 çdo shtetas shqiptar (si individ-jo biznes) kishte të drejtë të transferonte jo më shumë se 3.500.000 lekë ose vlerën e barabartë me të, për çdo vit kalendarik. Në vijim, ata të dy më kanë shpjeguar se detyrimet që kishin për blerje malli në Kinë ishin më shumë se 3.500.000 lekë, prandaj miqësisht, për shkak të marrëdhënieve miqësore që kishin me mua më kërkuan si nder të bëja transfertën e 34.000 USD në emrin tim, por për llogari të N. M.

Pranova t'i dërgoja ato para në Kinë në emrin tim për llogari të tij, duke qenë e bindur në sinqeritetin dhe ndershmërinë e tij dhe të të shoqes, në aktivitetin e tyre të pastër, të formalizuar e të përligjur, si dhe duke dashur t'i ndihmoj me dashamirësi, pa kurrfarë kundërshtimesh. Në atë kohë, edhe operatorja e bankës më deklaroi se ky veprim ishte tërësisht i ligjshëm dhe se nuk mund t'i atribuohet askujt si sjellje joetike apo si shkelje e legjislacionit fiskal, doganor apo tatimor. Këtë llogari në bankë e kam mbyllur në datën 31.3.2010¹⁴”.

5.3 Në vijim, pavarësisht nga shpjegimi i bërë prej saj se këtë transfertë e kishte bërë pasi z. N. M. dhe bashkëshortja e tij i kishin thënë se çdo shtetas shqiptar nuk mund të transferonte më shumë se 3.500.000 lekë ose vlerën e barabartë me të për çdo vit kalendarik, më tej, në mënyrë kontradiktore, në përgjigjet e dhëna për pyetësonin nr. 2, subjekti shpjegon se: “Për kryerjen e kësaj transferte kam vepruar në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr. 8269/1997, ‘Për Bankën e Shqipërisë’, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, në rregulloren ‘Për veprimtarinë valutore’. Sipas rregullores më lartcitur, në kohën kur është kryer ky veprim (datë 24.3.2010) nuk kishte kufizime për vlerën e lejuar për transfertë për askënd, qoftë individ apo biznes.”.

5.4 Në përgjigjet e pyetësonit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se nuk ka asnjë marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje apo huadhënieje me z. N. M. dhe transferta është bërë në mirëbesim dhe pa kundërshtim, prandaj nuk ka detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë për shumën 34.000 USD, e transferuar nëpërmjet Bankës ICB në datën 24.3.2010.

5.5 Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar një deklaratë të z. N. M. me të cilën deklaroi: “Sasia prej 34.000 (tridhjetë e katër mijë) USD e transferuar në Kinë nga znj. Semiramis Hoxholli në datën 24.3.2010 në Bankën Ndërkombëtare Tregtare janë për llogarinë time”.

5.6 Gjatë shpjegimeve të saj, subjekti i ka kërkuar Komisionit që t'i referohet si provë dëshmisë që z. N. M. ka dhënë para Komisionit përgjatë hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit A.Y., i cili ashtu si znj. Semiramis Hoxholli ka transferuar për llogari të z. N.M. para në drejtim të një shtetasi kinez (dy herë në vitin 2010, një herë në vitin 2012 dhe në vite të tjera deri në vitin 2015, sipas atyre që vetë ai ka pranuar¹⁵).

5.7 Sipas kërkesës së subjektit, Komisioni administroi në cilësinë e provës procesverbalin mbi marrjen e deklarimeve të shtetasit N. M., mbajtur në Komision, në kuadër të procedurave të rivlerësimit të subjektit A.Y. .

5.7.1 Në këtë dëshmi, z. N. M. sqaron arsyet pse transfertat janë bërë nga z. A. Y. dhe raportet që kishte me këtë subjekt, si dhe rrethanat e njohjes me të. Z. N. M. ka shpjeguar se merret me tregti mallrash që vijnë nga Kina dhe transfertat e bëra nga z. A. Y. janë bërë në emër të tij (të z. M.), për t'i larë huan shtetasit kinez që të vinte malli, sepse ka qenë rregullore e bankës që lejonte vetëm 3.500.000 që mund të dërgoheshin si person fizik, si individ pa zhdoganim.

¹⁴Bashkëlidhur ka depozituar kërkesën e bërë pranë ICB-së për mbylljen e llogarisë, mandatpagesën për mbylljen e llogarisë dhe shkresën “debitit advice” “account is closed”, datë 31.3.2010.

¹⁵Pika 22 e germës “e” të vendimit të KPA-së.

Gjithashtu, z. N. M. ka sqaruar se subjekti A. Y. e ka hapur këtë numër llogarie me sugjerimin e operatores së bankës kur ka shkuar për të bërë transfertën (pasi ajo i ka thënë që kështu është më e lehtë).

5.7.2 Z. N.M., i pyetur nga Komisioni nëse për këto transaksione ka përdorur vetëm z. A.Y. apo edhe persona të tjerë, është shprehur se *ka edhe të tjerë*. Pyetjes nëse i informonte ata në lidhje me arsyen pse bëhej kjo dhe nëse i shpërblente, z. N. M. i është përgjigjur se i informonte, ishte shumë transparent dhe se ata e kryenin procesin e transferimit të parave pa shpërblim, vetëm për shkak të marrëdhënieve që kishin.

5.7.3 Në lidhje me këtë dëshmi të marrë me kërkesë të subjektit, Komisioni e analizoi atë në raport me rastin e subjektit të rivlerësimit Semiramis Hoxholli dhe vlerësoi se ajo mund të përdoret për subjektin, vetëm për sa ai ka deklaruar se në këtë proces nuk ishte vetëm z. A. Y., por kishte edhe të tjerë, se ai i informonte ata, ishte shumë transparent dhe se këto veprime kryheshin nga personat e tjerë pa kundërshpërblim, vetëm për shkak të marrëdhënieve që kishin. Trupi gjykues, në vlerësimin e kësaj dëshmie, mban parasysh faktin se kjo dëshmi është dhënë për një subjekt tjetër rivlerësimi, me të cilin personi ka pasur marrëdhënie të ndryshme nga ato që kishte me subjektin e rivlerësimit. Konkretisht, z. N. M. ka deklaruar, ndër të tjera, se subjekti A. Y. ka qenë asistent avokat pranë zyrës së tij të avokatisë, për efekt të dhënies së provimit të avokatisë, ndërsa me subjektin e rivlerësimit Semiramis Hoxholli nuk ka pasur një raport të tillë me të.

5.8 Për sa më sipër, subjektit iu komunikua rezultati i hetimit dhe iu kërkua të japë shpjegime shtesë për këtë transfertë të kryer. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti u njoh edhe me mospërputhjen e konstatuar nga Komisioni midis shpjegimeve të saj mbi pamundësinë e z. N. M. për kryerjen e transfertës për shkak se *“... çdo shtetas shqiptar (si individ-jo biznes) kishte të drejtë të transferonte jo më shumë se 3.500.000 lekë ose vlerën e barabartë me të, për çdo vit kalendarik. Ata të dy më kanë shpjeguar se detyrimet që kishin për blerje malli në Kinë ishin më shumë se 3.500.000 lekë”* dhe citimit nga ana e saj të rregullores “Për veprimtarinë valutore”, duke shpjeguar se në kohën kur është kryer ky veprim (datë 24.3.2010) nuk kishte kufizime për vlerën e lejuar për transfertë për askënd, qoftë individ apo biznes.

5.9 Pas njohjes me rezultatet e hetimit, subjekti parashtrori se i qëndron shpjegimeve të dhëna më parë në përgjigje të pyetësorit nr. 2 në lidhje me këtë transfertë bankare, si e vërteta e vetme e sigurtë dhe se ky veprim, i cili mund të ngrejë dyshim për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, në kohën kur nuk ushtronte asnjë funksion publik në këtë sistem, nuk mund të merret në analizë në këndvështrim të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në vijim, subjekti ka parashtruar se ky koncept merr kuptim vetëm në kuadër të personave që ushtrojnë funksione publike, ndërkohë që vetë ishte thjesht studente dhe se e ka kryer atë veprim vetëm për dashamirësi, respekt dhe pa kurrfarë kundërshpërblimi, e bindur në ndershmërinë dhe aktivitetin e ligjshëm të z. N. M. .

5.10 Më tej, subjekti ka shpjeguar sërish se vendimi nr. 70/2009 i Bankës së Shqipërisë, cituar në relacion, e lejonte një veprim të tillë bankar dhe se ka vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin fiskal, doganor dhe tatimor, prandaj nuk mund të penalizohet për një normë që nuk ka ekzistuar ndonjëherë. Në shpjegimet e saj, subjekti ka pretenduar se: *“Sa kohë që vetë banka e miratoi si veprim, sa kohë që ata të dy si çift biznesmenësh në dijeninë time kurrë s’janë thirrur para organeve të drejtësisë për të dhënë shpjegime mbi dyshime të ngritura, sa kohë që as vetë Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave nuk e ka konsideruar veprim jolegjitim apo joetik, aq më pak mund t’i atribuohet si shkelje personit tim plot 11 vjet pas kryerjes dhe mbi 7 vjet pas marrjes së funksionit zyrtar”*.

5.11 Në lidhje me mospërputhjet në deklaratimet e saj mbi pamundësinë e z. N. M. për kryerjen e transfertës për shkak se ishte e kufizuar shuma që mund të transferohej dhe citimit që subjekti i bën rregullores për veprimtarinë valutore, sipas së cilës nuk kishte kufizime për vlerën e lejuar për transfertë, për askënd, subjekti shpjegoi se këto nuk janë kundërthënie apo kundërshti, por

ka cituar vetëm ligjin e kohës, më konkretisht, pikën 1 të vendimit nr. 70, datë 30.9.2009, të Bankës së Shqipërisë, “Për veprimtarinë valutore”, e cila përcaktonte se: “1. Transferimi i kapitalit nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentët dhe jorezidentët kryhet lirisht dhe pa kufizime [...]” dhe se “Për sa kohë që akti nënligjor i kohës, i sipërcituar, e ka lejuar një veprim të tillë bankar, nga çdokush, qartazi rrjedh se edhe unë kam vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin fiskal, doganor dhe tatimor. Sërish i qëndroj arsytimit se unë nuk mund të penalizohem për një normë që s’ka ekzistuar ndonjëherë dhe ky është tanimë parim i njohur në botën e së drejtës”.

5.12 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 22.9.2021, subjekti iu qëndroi parashtrimeve të bëra më parë me shkrim në lidhje me faktin se kjo transfertë ishte bërë para se të bëhej subjekt rivlerësimi, se ishte bërë vetëm për miqësi, nisur nga sinqeriteti i një studenteje 23-vjeçare dhe se nuk ishte veprim i kundërligjshëm.

5.13 Subjekti, e pyetur nga vëzhguesi ndërkombëtar¹⁶ nëse do ta bënte sërish këtë veprim në këtë moment nëse kryerja e një transferte të tillë do të ishte e ligjshme, u përgjigj: “Jo, nuk do ta bëja. Jo se ishte e paligjshme. Nuk thuhet kurrkund në asnjë pikë të legjislacionit fiskal, doganor apo tatimor, që është shkelje. Nuk është as shkelje morali dhe etike, për sa kohë nuk thuhet gjëkund që është e tillë, por sërish unë do t’i vija kufi mirësisë sime si njeri, do isha më vigjilente për qëllimet e tij, duke pasur parasysh se ky veprim qenkësh bërë prej tij edhe me të tjerë persona për qëllime të tij të bëra të ditura tani, nuk do ta kisha bërë kurrë sërish për një arsye të thjeshtë, kurrë nuk do ta kisha vendosur sërish veten në pozitën ku figura ime, ku vlerat e mia si njeri në radhë të parë dhe si profesioniste sot në radhë të dytë, se po gjykohej sot si gjyqtare, do viheshin në dyshim, do t’ia evitoja vetes këtë gjë”.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në vlerësimin e të gjitha provave dhe fakteve, së pari sjell në vëmendje se Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin për subjektin A. Y.¹⁷ ka vlerësuar se për sa i përket vlerës provuese, deklaratat e dhëna nga z. N. M. bien ndesh me kufirin e lejimit të provave me dëshmitarë, sipas përcaktimeve të nenit 231 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit “Prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për vlefshmërinë ose provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë”, si dhe me përcaktimin e nenit 232 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit “Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë (...)”.

5.14 Për aq sa mund të bëhet paralelizëm midis këtyre dy rasteve, në rastin e z. A. Y., Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në vendimin e sipërpërmendur është shprehur ndër të tjera, se vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes nuk janë të zbatueshme vetëm për magjistratët e emëruar dhe të caktuar në detyrë, por edhe për subjektet e rivlerësimit që janë në proces të përgatitjes për magjistratë të ardhshëm dhe se transfertat bankare në mënyrë të përsëritur, të pajustificuara me burime të ligjshme, tregojnë mungesë të theksuar të përmbushjes së vlerave themelore që duhet të udhëheqin një magjistrat të ardhshëm, sipas nenit 3 të ligjit nr. 96/2016¹⁸.

5.15 Në kontekstin e vendimit të sipërpërmendur të KPA-së, të marrë si analogji për shkak të faktit të njëjtë që i bashkon dy çështjet, pra faktit që të dy subjektet në vitin 2010 kanë kryer transfertë ndaj një shtetasi kinez për llogari të z. N. M., në funksion të aktivitetit të tij tregtar, çmohet të evidentohen elementët që i bashkojnë dhe që i ndajnë këto dy raste:

- a) Ashtu si të dy subjektet pretendojnë se rezulton e provuar se transfertat për llogari të z. N.M. i kanë kryer pa kundërshtim, bazuar në raporte mirëbesimi.

¹⁶Në seancën dëgjimore.

¹⁷Vendimi nr. ***, datë 20.11.2019, pika 30.

¹⁸Pikat 36.1 dhe 50.1.

- b) Të dy subjektet sqarimet i kanë deklarative, pa shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të vlerave të transferuara të tyre apo të z. N. M., pa i shoqëruar me dokumente tatimore apo doganore.
- c) Z. A. Y., në kohën e kryerjes së transfertës, ka qenë asistent/avokat i z. N.M. (sipas deklarimeve të tyre), ndërsa subjekti Semiramis Hoxholli në atë kohë ishte diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë dhe po ndiqte ciklin *Master Shkencor të Nivelit të Dytë* dhe transfertën e ka kryer për shkak të raporteve miqësore që kishte me z. M. dhe bashkëshorten e tij (sipas atyre që vetë ajo ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 2).
- d) Z. A.Y. ka kryer transferta disa herë; dy herë në vitin 2010, një herë në vitin 2012 dhe sipas atyre që ka pranuar, edhe në vite të tjera deri në vitin 2015, ndërsa subjekti Semiramis Hoxholli ka kryer transfertë vetëm një herë dhe, sikurse trajtuam më lart, disa ditë më pas e ka mbyllur llogarinë.

5.15.1 Në lidhje me pretendimin e subjektit se transfertën e ka kryer pasi sipas vendimit nr. 70, datë 30.9.2009, të Bankës së Shqipërisë, “Për veprimtarinë valutore”, ishte e kufizuar shuma që mund të transferohej, sepse çdo shtetas shqiptar (si individ, jo biznes) kishte të drejtë të transferonte jo më shumë se 3.500.000 lekë ose vlerën e barabartë me të, për çdo vit kalendarik, ndërkohë që detyrimi që z. N. M. kishte për blerje malli në Kinë e kalonte këtë vlerë, trupi gjykues çmon se ky pretendim nuk është i mbështetur në vendimin e sipërpërmendur të Bankës së Shqipërisë. Komisioni solli në vëmendje edhe vendimin e sipërpërmendur të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit A.Y.¹⁹, sipas të cilit pikat 1 dhe 3 të vendimit nr. 70, datë 30.9.2009, përcaktojnë se: *“1. Transferimi i kapitalit nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentët dhe jorezidentët kryhet lirisht dhe pa kufizime. [...] 3. Subjektet e licencuara kryejnë transferimin e kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të klientëve të tyre, pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar si më poshtë, si dhe dokumenteve të tjera shtesë që subjektet mund të çmojnë të arsyeshme: (a) për personat fizikë tregtarë dhe juridikë: (i) deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit dhe i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që kërkohet të transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet; (ii) vendimi i organit vendimmarrës të klientit për kryerjen e transferimit të kapitalit; (iii) ekstrakti i regjistrimit tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit; (iv) vërtetimi nga zyra e tatim-taksave, për shlyerjen e të gjitha detyrimeve fiskale ndaj shtetit; (b) për personat fizikë: (i) deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit, deklarimi i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet”*. Pra, kjo rregullore e Bankës së Shqipërisë nuk përcaktonte kufizime në vlerat e transfertave, por parashikonte disa elemente për transfertën, të cilat kanë të bëjnë me burimin e krijimit të kapitalit.

5.15.2 Komisioni mbajti parasysh vendimin e sipërpërmendur të Kolegjit, sipas të cilit: *“Në një kohë që nuk qëndron pretendimi se subjekti i rivlerësimit ka vepruar me mirëbesim në kryerjen e transfertave bankare për qëllime tregtare, por pranohet nga subjekti i rivlerësimit dhe z. N. M. se këto transferta bankare kishin për objekt veprimtarinë tregtare, por pa u shoqëruar me dokumentet përkatëse tatimore, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se këto transferta janë sjellje të kryera nga subjekti i rivlerësimit jashtë ushtrimit të funksionit dhe gjatë procesit të rivlerësimit, që janë në kundërshtim me:*

- a) sjelljen e subjektit të rivlerësimit, sjellje e cila mbahet parasysh nga trupi gjykues i Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016;
- b) vlerat themelore pasi nuk garantojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas përcaktimit të pikës 5, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2016; dhe
- c) faktin se këto sjellje cenojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, pasi nuk janë në përputhje me masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit edhe kur nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare dhe për të mbrojtur dhe forcuar reputacionin e organeve të

¹⁹Vendimi nr. ***, datë 20.11.2019.

drejtësisë dhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 96/2016²⁰”.

5.16 Në përfundim, pasi analizoi si më lart, duke mbajtur në konsideratë edhe shpjegimet e subjektit dhe përgjigjet në seancë dëgjimore, trupi gjykues çmon se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme të tij ose të z. N. M. për krijimin e vlerës së transferuar për llogari të këtij të fundit, si dhe nuk provoi shkakun për të cilin ka kryer këtë transfertë për llogari të këtij shtetasi.
- Duke pasur në konsideratë faktin se subjekti nuk ka qenë në ushtrim të ndonjë funksioni të caktuar në këtë periudhë, ka qenë studente në nivel *master* dhe kishte kryer një transfertë të vetme, trupi gjykues çmon se kjo gjetje nuk mund të ndikojë në cilësitë e saj si magjistrate dhe, për pasojë, të vlerësohet si një element që sipas nenit 3 të ligjit nr. 96/2016 të cenojë besimin e publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë.

6. Transferta drejt/nga Gjermania

6.1 Institucionet financiare MoneyGram dhe AK-Invest²¹ përcollën informacion në Komision mbi disa dërgesa parash të nisura nga subjekti dhe disa të marra prej tij përgjatë periudhës dhjetor 2011 – 23.11.2017 drejt/nga Gjermania, nga shtetasi A. Ll. D. .

6.2 Nga ky informacion rezultoi se vlera e përfituar nga subjekti është në total 2.390 euro dhe, konkretisht:

- a) gjatë vitit 2015 janë nisur 7 dërgesa me përfitues subjektin e rivlerësimit, të cilat në vlerë totale janë 1.170 euro;
- b) vlera e përfituar nga subjekti për vitin 2016 është 1.120 euro (5 transferta);
- c) vlera e përfituar nga subjekti për vitin 2017 është 100 euro.

6.3 Vlera e dërguar nga subjekti në favor të marrësit A. D., në vitin 2016 është 550 euro (3 dërgesa) dhe në vitin 2017 është 100 euro (një dërgesë).

6.4 Komisioni konstatoi se në asnjërin prej DIPP-ve të viteve 2015, 2016 dhe 2017 subjekti nuk i ka deklaruar këto si të ardhura.

6.5 Nga formularët e tërheqjeve dhe dërgesave bashkëlidhur përgjigjes nga këto institucione (ku subjekti herë është dërguese dhe herë marrëse), rezulton se në disa nga formularët profesioni i saj është plotësuar avokate, ndërsa në një rast është plotësuar “biznes”.

6.6 Subjekti, e pyetur nga Komisioni mbi këto veprime²², duke përfshirë qëllimin e tyre dhe nëse gjatë kësaj periudhe ka ofruar shërbimin e avokatisë, shpjegoi se: “Z. A. Ll. D. është mik i mirë imi dhe i familjes time prej shumë vitesh. Është me origjinë shqiptare, por jeton në Gjermani dhe prej vitesh gëzon edhe shtetësinë gjermane. Është e vërtetë se në ndër vite e kemi ndihmuar njëri-tjetrin me shuma tejet modeste në shenjë miqësie e ndihme reciproke, sipas nevojave që kemi pasur. Për këtë qëllim, është përdorur rrjeti AK-Invest, me transaksione monetare të kryera me anë të shërbimit MoneyGram në cilësinë e dërguesve/përfituesve dhe anasjelltas. Këto shuma variojnë nga 100 deri në 300 euro/vit, duke mos e tejkaluar, në asnjë rast, shumën 500 euro/vit”.

6.7 Për të provuar këtë fakt, subjekti ka depozituar, bashkëlidhur, vërtetimin nr. *** prot., datë 27.11.2020, nga institucioni financiar “AK-Invest”, nga i cili rezulton se vlera totale e dërguar nga subjekti për vitin 2016 është 550 euro (3 dërgesa), ndërsa vlera totale e marrë prej saj me dërgues shtetasin A.D. për vitin 2016 është 1.220 euro, vlerë kjo e marrë me 5 dërgesa.

²⁰ Pika 53.5 e tij.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.12.2020).

²² Pyetësori nr. 2.

6.8 Në lidhje me profesionin që rezultoi në formular, subjekti shpjegoi se: *“Në lidhje me faktin se në disa prej formularëve të plotësuar të tërheqjes, është bërë përshkrimi i profesionit tim herë si ‘avokate’ e herë si ‘biznes’, ju argumentoj se kjo nuk qëndron. Unë nuk e kam ofruar kurrë shërbimin e avokatisë dhe as kam pasur ndonjëherë biznes me këtë veprimtari apo të çdolloji tjetër. Titullin ‘Avokat’ vërtet e kam përfituar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, por nuk e kam ushtruar kurrë si profesion. Kjo edhe për faktin se sapo kam marrë licencën e avokates, kam shkuar dhe e kam pezulluar efektin e saj si akt administrativ sepse po në të njëjti vit, m’u dha e drejta e studimit për konkursin e fituar në Shkollën e Magjistraturës. Përshkrimi që mund të ketë dhënë shërbimi MoneyGram nëpërmjet rrjetit AK-Invest rreth titullit tim si avokate apo biznes, nuk përbën bazë zyrtare shtetërore të të dhënave. Këto transfertat modeste që janë tërhequr apo dërguar ndër vite mes meje dhe mikut tim A.D. nuk kanë lidhje me asnjë aktivitet profesional si avokate, por e kanë burimin në një marrëdhënie të pastër miqësore personale dhe familjare, pa kundërshpërblim”.*

6.9 Subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit dhe iu kërkua të japë shpjegime mbi arsyen e mosdeklarimit të këtyre transfertave në DIPP dhe në deklaratën *Vetting*.

6.10 Në shpjegimet e paraqitura në Komision pas njohjes me rezultatet e hetimit, subjekti deklaroi përsëri që transferimi i këtyre shumave me shtetasin A. D. është bërë në kuadër të një ndihme njerëzore dhe miqësore dhe se kjo ndihmë modeste mes tyre ka filluar shumë më herët se të bëhej subjekt deklarues në ILDKPKI dhe, rrjedhimisht, shumë më herët se të merrete funksionin e gjyqtarës. Lidhur me këtë subjekti ka shpjeguar se: *“Kurrë s’kam pasur qëllim fshehjeje të asgjëje që kam përfituar/dërguar si para të ligjshme për sa kohë nuk mund të fshihen, në asnjë lloj mënyre e trajte, një apo disa veprime të bëra përmes institucioneve financiare jo-bankë”.*

6.11 Në lidhje me arsyen e mosdeklarimit të këtyre shumave në deklaratat periodike, subjekti u shpreh se: *“Mosdeklarimi në deklaratat periodike për vitet 2015, 2016 dhe 2017, si dhe në deklaratën *Vetting* të këtyre transfertave mund t’i atribuohet thjesht harresës sime dhe pakujdesisë sime, nisur edhe nga vlera e tyre e vogël. Kështu, në vitin 2015 kam marrë nga këto dërgesa në total 250 euro, në 2016-tën në total 1.120 euro dhe në 2017-ën vetëm 100 euro. Asnjëra prej tyre, mëvetësisht, nuk e ka tejkaluar shumën e barasvlershme me 500 euro. Ju bëj me dije se shpjegimi im përputhet edhe me shpjegimin që ju kam dhënë në pyetjen nr.17 të pyetësorit të parë standard ku kam deklaruar se: ‘Nuk kam marrë dhe as nuk kam nxjerrë jashtë Shqipërisë të holla (cash), mbi shumën e barasvlershme me 500 euro, gjatë periudhës së deklarimit (20.11.2015 – 20.1.2017), përveçse të holla (cash) në vlerë të vogël fare, të marra apo nxjerra, të cilat, secila, nuk e kalon shumën e barasvlershme me 500 euro”.*

6.12 Në seancën dëgjimore subjekti mbajti të njëjtin qëndrim, duke parashtruar të njëjtat argumente si më lart dhe shpjegoi se: *“Nuk kam pasur qëllim fshehjeje të asgjëje që kam përfituar apo dërguar dhe vetë si para të ligjshme, për sa kohë nuk mund të fshihen në asnjë lloj mënyre dhe trajte, një apo disa veprime të bëra midis institucioneve financiare jo bankë”.*

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se në analizë të provave dhe fakteve ka një pasaktësi nga subjekti lidhur me mosdeklarimet të transfertave, gjetje kjo e cila do të vlerësohet në përfundim lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë.

7. Automjet në përdorim të subjektit

7.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka në përdorim (*usus*) sipas nenit 259 të Kodit Civil një automjet tip “SMART”, me targa AA ***, vit prodhimi 2006, me nr. shasie ***, në pronësi të vëllait, z. E. Xh. H., fituar prej tij sipas aktit të blerjes, nr. s’ka, datë 26.4.2017. Nga certifikata e pronësisë së automjetit, rezultoi se automjeti është regjistruar në pronësi të shtetasit E. Xh. H. dhe pronësia mbi të është fituar me kontratë shitblerjeje datë

26.4.2017 (nr. s'ka). Subjekti deklaroi, gjithashtu, se këtë automjet e ka në përdorim që prej janarit të vitit 2019 e në vijim.

Hetimi/analiza financiare i/e kryer nga Komisioni

7.2 Nga korrespondenca me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit²³ rezultoi se shtetasi E. Xh. H. (vëllai i subjektit) ka në pronësi automjetin tip "SMART", me targa AA ***, me nr. shasie ***.

7.3 Nga dosja e automjetit, përcjellë nga DPSHTRR-ja,²⁴ rezultoi se:

- automjeti është blerë në Gjermani me kontratën e shitblerjes të lidhur në datën 26.4.2017 midis shtetasve E. H. (blerësi) dhe I. M. (shitësi)²⁵, kundrejt vlerës 900 euro;
- Automjeti është zhdoganuar në Durrës, me anë të deklaratës doganore datë 3.5.2017, ku dërgues është znj. I. V. M., Ausburg, Gjermani dhe marrës është z. E.H., Elbasan;
- automjeti është regjistruar në pronësi të shtetasit E.H., më 8.5.2017, dhe në po këtë datë është blerë polica e sigurimit, ku pronar është shtetasi E. H. dhe përdorues është subjekti i rivlerësimit. Në vitet pasardhëse, policëmbajtës i vetëm është shtetasi E. H. si pronar dhe përdorues.

7.3.1 Nga korrespondenca me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit²⁶ dhe me DPSHTRR-në²⁷, si dhe nga të dhënat e sistemit elektronik të AMF/Qendra e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik rezultoi se subjekti disponon leje drejtimi, por nuk ka automjet në pronësi.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se hetimi lidhur me deklarin e të drejtës së përdorimit të këtij automjeti, i cili deklarohet që përdoret pas deklaratës *Vetting*, ka pasur si qëllim që të provojë nëse ka të bëjë me një automjet, që mund të ishte në pronësi të saj.

Për këtë arsye, trupi gjykues ka bërë një analizë, joshteruese, të mundësisë që vëllai i subjektit, personi i lidhur, ka pasur për të blerë këtë automjet me të ardhura të ligjshme, sipas ligjit nr. 84/2016.

Nga analiza rezultoi se vëllai i subjektit, z. E. H., nuk ka pasur mundësi të krijojë këtë pasuri me burime të ligjshme, duke rezultuar me një diferencë në vlerën 428.906 lekë, pa përfshirë këtu mundësinë e të ardhurave në banesë që këta të fundit mund të kenë pasur, pasi rezultojnë me depozita dhe tërheqje të tyre, e analizuar kjo në vijim në mënyrë të detajuar te personat e lidhur.

Sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti ka bërë një deklarin të saktë të përdorimit të këtij automjeti dhe nuk rezultoi e provuar që kjo pasuri të jetë e saja, pavarësisht se është krijuar pas deklaratës *Vetting*.

Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni për personat e lidhur

7.4 Nga hetimi rezultoi se nga momenti i marrjes së detyrës, deri më 5.9.2016²⁸, në përbërjen familjare të subjektit kanë qenë edhe prindërit e saj (Xh. dhe Z. H.), si dhe vëllai (E.H.). Në datën 5.9.2016, subjekti është shkëputur nga trangu familjar dhe, për pasojë, në përbërjen familjare rezultoi e vetme.

7.5 Në pikën 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: *Person i lidhur është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, i përbërë nga bashkëshorti/ja,*

²³Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.12.2020).

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 10.6.2021 (protokolluar në Komision me nr.*** prot., datë 11.6.2021).

²⁵Kontratë e përkthyer nga përkthyes A.E., vërtetuar përkthimi nga noter E. K., Elbasan, me nr.***prot., datë 6.5.2017.

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.12.2020).

²⁷Shkresat nr.*** prot., datë 21.12.2020 dhe nr. ***prot., datë 11.6.2021.

²⁸Shkresë nr. ***prot., datë 11.12.2020, e DPGJC-së.

bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit”.

7.6 Bazuar në këtë përcaktim që ligji bën për personat e lidhur, pavarësisht nga fakti se në deklaratën *Vetting* subjekti ka qenë e vetme në përbërjen familjare, trupi gjykues ka hetuar për pasuritë e personave që kanë qenë pjesë e përbërjes familjare që në momentin e fillimit të periudhës së rivlerësimit. Nga ky hetim, rezultoi si vijon:

8. Veprime bankare të personit të lidhur të subjektit/nëna Z. H.

8.1 Nga komunikimi me “Credins Bank”²⁹, rezulton se znj. Z. H. (nëna e subjektit) ka derdhur *cash* në llogarinë e saj vlerën 57.000 euro, në datën 3.9.2008. Kjo shumë është mbyllur në formën e depozitës 12-mujore dhe është rinovuar deri në datën 3.9.2012, ku ka pasur vlerën 69.150 euro dhe është tërhequr po në këtë datë.

8.2 Me anë të pyetësorit nr. 2 subjektit i janë kërkuar shpjegime mbi burimin e kësaj vlere të depozituar në “Credins Bank” dhe, në përgjigje, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtuar shpjegimet:

“Së pari: bazuar në pikat 12 dhe 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, periudhë rivlerësimi është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit, gjatë së cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji. Person i lidhur është ..., si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit. Referuar kësaj dispozite ligjore si dhe certifikatës familjare të depozituar prej meje pranë jush, që ndodhet në dosjen e rivlerësimit, unë, që prej datës 5.9.2016 jam shkëputur nga trangu familjar dhe rezultoj ‘kryefamiljare’. Periudha në të cilën kjo vlerë është depozituar prej nënës sime në ‘Credins Bank’ (datë 3.9.2008) nuk është periudhë rivlerësimi për mua në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Periudha ime e rivlerësimit fillon gati 7 vjet e dy muaj më vonë, ekzaktësisht në datën 20.11.2015, kur jam dekretuar nga Presidenti i Republikës për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pra, në vitin 2008 unë kam qenë studente dhe jo vetëm nuk kam punuar si subjekt rivlerësimi, por nuk kam qenë as subjekt deklarues në ILDKPKI, që të më lindë detyrimi të justifikoj burimin e kësaj pasurie.

Së dyti: Pavarësisht vlerësimit tim si më lart, duke pasur dëshirën e mirë për të bashkëpunuar, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se shuma prej 57.000 euro, depozituar më 3.9.2008 pranë ‘Credins Bank’ nga nëna ime, rrjedh nga të ardhurat që im vëlla E. H. ka realizuar në emigracion në shtetin grek, ku ka jetuar për rreth 15 vjet. Theksoj se gjatë kohës kur prej tij janë realizuar këto të ardhura që më pas janë depozituar në bankë prej nënës time, unë kam qenë studente.

Së treti: Koha e krijimit të këtyre të ardhurave daton gati një dekadë e gjysmë përpara se të miratohej dhe të hynte në fuqi paketa kushtetuese e reformës në drejtësi si dhe ligji nr. 84/2016. Pra, në kohën e krijimit të tyre unë nuk e gëzoja statusin e subjektit të rivlerësimit. Për shkak të kësaj situate, im vëlla nuk ka pasur ndonjë detyrim ligjor të tregohej i kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tij në atë kohë, përveç sa ai e ka çmuar të nevojshme sipas kujdesit të një qytetari normal. Dihet se gjatë viteve të tranzicionit, shqetësimi parësor i qytetarëve të ndershëm e nevojtarë (sikurse janë edhe familjarët e mi) nuk ishte ruajtja e anës dokumentare të çdolloj aktiviteti që u prodhonte të ardhura, por ka qenë nevoja reale e nxjerrjes dhe realizimit të të ardhurave për të siguruar jetesën. Për rrjedhojë, unë nuk disponoj asnjë dokumentacion për të provuar burimin e kësaj pasurie, përveç shpjegimeve verbale të familjarëve të mi dhe vetë përvojës së jetesës sime në familje”.

²⁹Shkresë nr. *** prot., datë 16.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. ***prot., datë 17.12.2020).

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se kjo depozitë është krijuar nga personi i lidhur i subjektit para se znj. Semiramis Hoxholli të bëhej subjekt rivlerësimi, si dhe nuk ka të dhëna që subjekti ka kontribuar në krijimin e saj.

9. Veprime bankare të personit të lidhur/babai të subjektit Xh. H.

9.1 Nga informacioni i marrë nga “Raiffeisen Bank”³⁰ rezultoi se në datën 13.5.2009, z. Xh.H. (babai i subjektit) ka derdhur *cash* vlerën 35.000 euro me përshkrimin “të ardhura nga emigracioni”, e cila është përdorur për hapjen e një depozite në këtë bankë.

9.2 E pyetur nga Komisioni³¹ mbi burimin e kësaj vlere, subjekti shpjegoi se: *“Lidhur me këtë gjetje, vlej në të njëjtën cilësi ligjore të gjitha shpjegimet që iu kam dhënë në pikën 2 dhe 3 të këtij pyetësori. Në këtë datë, pra, më 13.5.2009, unë jo vetëm që nuk kam qenë subjekt rivlerësimi, por nuk kam qenë as subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, që të më lindë detyrimi të justifikoj burimin e kësaj pasurie. Pra, momenti i kryerjes së kësaj derdhjeje në bankë prej babait tim Xh. H., është bërë shumë vite përpara asaj që njihet si periudhë rivlerësimi për mua në kuptim të pikës 12, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Në këtë periudhë kam pasur cilësinë e studentes së drejtësisë. Shuma prej 35.000 euro rrjedh, po ashtu, nga të ardhurat që im vëlla ka realizuar falë punës së tij në emigracion në Greqi. Kjo përkon edhe me vetë përshkrimin që ka bërë banka në momentin e depozitimit nga im atë si ‘të ardhura nga emigracioni’”.*

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se kjo depozitë është krijuar nga personi i lidhur me subjektin para se të bëhej subjekt rivlerësimi, madje para se të bëhej subjekt deklarimi dhe nuk ka të dhëna që subjekti ka kontribuar në krijimin e saj.

10. Transferta në llogarinë bankare të personit të lidhur/vëllai i subjektit E. H.

10.1 Nga “Credins Bank”,³² Komisioni u informua se në llogarinë e vëllait të subjektit, z. E. H., për periudhën kohore 6.1.2015 – 9.1.2015, është transferuar shuma totale prej 8.600.000 lekësh nga shoqëria “***” sh.p.k.

10.2 Me anë të pyetësorit nr. 2, subjekti është pyetur se cila është marrëdhënia e vëllait me këtë shoqëri dhe cili është burimi/qëllimi i transfertave nga kjo shoqëri për vëllain e subjektit.

10.3 Në mënyrë të përmbledhur, shpjegimet e subjektit, për këto pyetje, janë si vijon: *“Vëllai im, z. E. H. nuk është person i lidhur me mua në kuptim të pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sepse kryerja e kësaj transferte është bërë prej tij më 6.1.2015, pra, jashtë periudhës që konsiderohet periudhë rivlerësimi. Në datën 6.1.2015 në të cilën është identifikuar ky veprim i tim vëllai me këtë subjekt privat, unë jo vetëm që nuk kam punuar pasi kam qenë duke ndjekur vitin e dytë pranë Shkollës së Magjistraturës, por nuk kam qenë as subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, që të më lindë detyrimi të justifikoj burimin e kësaj pasurie. Gjithashtu, deklaroj se nuk kam dijeni se cila është shoqëria “***” sh.p.k., megjithatë, falë hulumtimeve të mia në faqen zyrtare të QKB-së, del se kjo shoqëri ka për objekt aktiviteti, ndër të tjera, edhe këmbimin valutor, pra, operon si agjent për transferimin e parave me subjekte jo bankë. Me shumë gjasë, shoqëria e identifikuar prej jush ka qenë agjenti që ka bërë këmbimin valutor të eurove që im vëlla ka sjellë nga Greqia në monedhë shqiptare (lekë), shumë e cila është përdorur më pas prej tij për blerjen e pasurisë së paluajtshme. Sa i përket burimit të kësaj transferte, sikurse shpjegova dhe më lart, kjo pasuri është realizuar me të ardhurat që im vëlla ka siguruar në emigracion, në Greqi. Këto para, në mungesë të tij janë administruar nga prindërit e mi, janë depozituar prej tyre në bankë, ndër vite, si dhe kur është kthyer nga emigracioni, respektivisht në vitin 2014, janë materializuar në pasuri të paluajtshme. Referuar kontratës së shitblerjes që*

³⁰Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.12.2020).

³¹Pyetësori nr. 2.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 16.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.12.2020).

*disponoj në cilësinë e provës³³, realizuar midis tim vëllai në cilësinë e blerësit dhe z. A. F. në cilësinë e shitësit, bëhet fjalë jo për banesë, porse për njësi shërbimi, kati i parë i një ndërtese 45.58 m², ndodhur në lagjen ‘***’, Elbasan”.*

10.4 Bashkëlidhur këtij shpjegimi, subjekti ka përcjellë pranë Komisionit dokumentacionin: (i) mandatar-këtimin nr***, datë 24.12.2014, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas të cilit nga z. E. H. u arkëtua në shumën 60.000 euro; (ii) kontratën e shitblerjes nr***, datë 21.1.2015, realizuar midis vëllait të saj E. H. në cilësinë e blerësit dhe z. A. F. në cilësinë e shitësit; (iii) vërtetimin nga dokumentet hipotekore lëshuar në datën 2.2.2015, për objektin e blerë me anë të kësaj kontrate.

10.5 Komisioni i kërkoi subjektit³⁴ të jepte shpjegime se në çfarë aktivitetesh fitimprurëse ka qenë i përfshirë vëllai i saj gjatë qëndrimit në shtetin grek, mbi bazën e të cilave ka përfituar të ardhurat e deklaruara prej saj gjatë hetimit nga Komisioni. Iu kërkua që informacioni të shoqërohet me dokument provues (kontratë pune, vërtetime punësimi, vërtetime mbi të ardhurat e tij, taksa ose tarifa të paguara që lidhen me të ardhurat e tij ose çdo dokumentacion tjetër provues mbi punësimin dhe vlerën e të ardhurave).

10.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, në lidhje me këtë pyetje, subjekti parashtroi se: *“Së pari (sikurse ju kam parashtruar edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2) ju sjell në vëmendje pikat 12 dhe 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në të cilat parashikohet se: ‘12. Periudha e rivlerësimit’ është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit, gjatë të cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji”; 13. ‘Person i lidhur’ është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe Komisionerin Publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe Komisioneri Publik për periudhën e rivlerësimit.*

Referuar kësaj baze ligjore, si dhe certifikatës familjare të depozituar prej meje pranë jush dhe që ndodhet në dosjen time të rivlerësimit, unë, që prej datës 5.9.2016, jam shkëputur nga trangu familjar dhe figuroj ‘kryefamiljare’. Në këtë kuadër, im vëlla E. H., nuk quhet person i lidhur me mua.

Së dyti, jo vetëm që im vëlla E.H. nuk është person i lidhur me mua në kuptim të ligjit, por edhe po të quhej i tillë, çdo gjë që ai ka fituar si rezultat i punës së tij, nuk përkon dhe nuk lidhet me periudhën time të rivlerësimit dhe as me qenien time si gjyqtare. Ne jemi rritur larg njëri-tjetrit që fëmijë e deri tani vonë. Funksinin Magjistrat unë e kam marrë më 20.11.2015, me datën e dekretimit për herë të parë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sakaq, im vëlla ka jetuar dhe punuar në Athinë, Greqi, përgjatë periudhës 1999 – 2014, pra, rreth 15 vjet. Sikurse ju kam sqaruar edhe në pyetësorët paraardhës, ai ka shkuar në moshën 17 vjeçare atje dhe është kthyer 32 vjeç në Shqipëri. Për rrjedhojë, periudha e qëndrimit dhe punësimin të tim vëllai në emigracion në shtetin grek, për të cilën Ju më kërkoni shpjegim dhe dokumente provuese, nuk është ‘periudhë rivlerësimi’, për mua në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe as të ardhurat e punësimin të tij nuk kanë lidhje me mua në kuadër të këtij procesi. Unë e im vëlla nuk kemi pasur kurrë marrëdhënie financiare. Në vitin 1999 kur ai ka emigruar, unë kam qenë fëmijë, 14 vjeç, dhe kur ka ardhur, kam qenë në vit të parë të studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës. Kësisoj, nuk mund të më lindë detyrimi të justifikoj burimin e të ardhurave të tim vëllai në emigracion.

Së treti, vlerësoj të sjell në vëmendjen tuaj se koha e krijimit të të ardhurave modeste të tim vëllai për të cilat më kërkoni dokumentacion, daton gati një dekadë e gjysmë përpara se të miratohej e të hynte në fuqi paketa kushtetuese e reformës në drejtësi si dhe ligji nr. 84/2016. Pra, në kohën e krijimit të tyre, unë nuk e gëzoja statusin e subjektit të rivlerësimit. Për shkak

³³Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 21.1.2015, realizuar midis vëllait të saj E. H. në cilësinë e blerësit dhe z. A. F., në cilësinë e shitësit.

³⁴Me anë të pyetësorit nr. 4.

të kësaj situate, ai (im vëlla) nuk ka pasur ndonjë detyrim ligjor të tregohej i kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tij në atë kohë përveç se, për sa ai ka çmuar të nevojshme sipas kujdesit të një qytetari normal. Dihet se, për shkak të realitetit historik të zhvillimit të shoqërisë shqiptare në vitet e tranzicionit, shqetësimi parësor i qytetarëve të ndershëm e nevojtarë të vendit tonë (sikurse është edhe im vëlla) nuk ishte ruajtja e kurimi i anës dokumentare të çdo lloj aktiviteti që u prodhonte të ardhura. Parësore ka qenë nevoja reale e nxjerrjes dhe realizimit të këtyre të ardhurave në funksion të qëllimit për të siguruar jetesën dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të tyre e të familjarëve të tyre. Për rrjedhojë, unë nuk kam disponuar deri në momentin e dërgimit të këtij pyetësi nga ana Juaj asnjë dokumentacion për të provuar burimin e të ardhurave të ligjshme të tim vëllai. Megjithatë, duke dashur të jem e hapur dhe transparente me Ju, në çdo gjurmë të këtij procesi serioz rivlerësimi, nga shpjegimet verbale me tim vëlla, ai arriti të më siguronte (aq sa ka mundur të ruajë si anë dokumentare, ndër vite) disa prova shkresore për sa Ju keni kërkuar. Theksoj se ka qenë tejet i vështirë, në mos i pamundur, sigurimi i dokumentacionit shkresor provues nga shteti grek për të provuar punësimin, të ardhurat e tatimet që ai ka derdhur mbi këto të ardhura. Qoftë unë, qoftë im vëlla, këto 10 ditë kohë që mu la afat, kemi bërë mjaftueshëm përpjekje për të aksesuar bazën dokumentare tatimore e kontributeve”.

10.7 Për të mbështetur shpjegimet në lidhje me veprimtarinë e vëllait në shtetin grek, subjekti i shoqëroi shpjegimet me dokumentacion³⁵, duke parashtruar se “nuk është e thënë që 15 vjet emigracion të gjejnë pasqyrim në këtë bazë dokumentare që unë po Ju ve në dispozicion sepse mund të ketë edhe shumë më tepër se kaq. Por me kujdesin e një qytetari të rregullt, im vëlla kaq ka mundur të sigurojë sot apo të ketë ruajtur ndër vite”. Gjithashtu, ka parashtruar se faturat e ruajtura si shkresa private prej vëllait, i ka vendosur në dispozicion të Komisionit sepse “ato provojnë atë çka më lart citova, kryerjen e çdo lloj pune të ndershme, përfshi atë të kopshtarisë ...”.

10.8 Gjithashtu, me pyetësin nr. 4, Komisioni i kërkoi sqarime subjektit se çfarë veprimtarie publike ose private, që gjeneron të ardhura, kryen vëllai i saj në Shqipëri, prej datës së kthimit nga emigrimi e në vijim? Sa është niveli i të ardhurave mujore ose vjetore të tij? Iu kërkua që shpjegimet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës provues.

10.9 Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti parashtroi se: “Sikurse më lart ju sqarova, unë nuk kam asnjë lloj marrëdhënieje financiare me tim vëlla, as për periudhën kur ka qenë emigrant e as tani që ka ardhur. Di t’ju them vetëm se prej kur është kthyer në vitin 2014 e ka pasur shumë të vështirë (dhe vazhdon ta ketë) për t’u punësuar e stabilizuar me punë. Edhe sot që më kërkoni shpjegim, është i papunë. Nuk kryen as edhe një lloj veprimtarie publike apo private. Nga shpjegimet që më ka dhënë, di se që prej 20.5.2015 – 19.5.2018, të vetmen pasuri të paluajtshme që munda të blinte me të ardhurat si emigrant, dyqanin prej 45.58 m² (njësi të cilën e keni identifikuar edhe ju në hetimin tuaj administrativ)³⁶, ia ka dhënë me qira shtetases S.G., e cila është person fizik tregtar me NIPT ***. Kundrejt lëshimit të kësaj pasurie të llojit njësi shtetases në fjalë për 3 vjet në gëzim e posedim të përkohshëm, im vëlla ka përfutur vleftën 8.000 lekë/muaj. Nga ndërprerja e kësaj kontrate (më 19.5.2018) dhe deri sot që plotësoj këtë pyetësor nuk di të ketë lidhur tjetër marrëdhënie qiraje për këtë pasuri e as të ketë përfutur të

³⁵1. Leje pune për të huajt L. ***, Athinë, datë 10.5.2002, lëshuar nga Drejtorja e Punës, Prefektura Athinë, Republika e Greqisë; 2. Vërtetimi i veçantë qëndrimi të ligjshëm, Athinë 23.3.2011, lëshuar nga Departamenti i Lejeve të Qëndrimit, Republika e Greqisë; 3. Llogari sigurimesh, Fondi i Unifikuar i Sigurimeve të Punonjësve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (IKA), Republika e Greqisë, me numër amze të të siguruarit ***, E. Xh. H.; 4. Bllok faturash, gjithsej 20 fatura prej datës 29.6.2006 e deri më 31.3.2007, të ruajtura si shkresa private prej vëllait të saj; 5. Pasqyrë likuiduese e tatimit mbi të ardhurat të personave fizikë në bazë të deklaratimit fillestar për tatimpaguesin E. Xh. H., nxjerrë nga Shërbimi Publik Tatimor, Republika e Greqisë për vitet tatimore 2001 – 2011.

³⁶Nga hetimi administrativ rezultoi që vëllai i subjektit, z. E. H., ka blerë pasurinë e paluajtshme nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. truall 45.58 m², nga ku ndërtesë 45.58 m². Ky informacion është dërguar nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. ***prot., datë 9.12.2020 (protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit me nr*** prot., datë 11.12.2020), si dhe nga vetë subjekti, me anë të dokumentacionit të përcjellë me pyetësin nr. 2. Për këtë njësi, në datën 12.5.2015 vëllai i subjektit ka lidhur kontratë qiraje me afat deri më 19.5.2018, kundrejt vlerës 8.000 lekë/muaj.

*ardhura të tjera nga asnjë lloj veprimtarie tjetër publike a private. Për sa më lart, bashkëlidhur ju dërgoj të vetmen provë që disponoj: kontratën e qirasë nr.***, datë 12.5.2015, nga Zyra e Noterisë Elbasan, Notere B. P.”.*

10.10 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 22.9.2021, Komisioni pyeti subjektin nëse asaj apo prindërve i kishte ngjallur dyshime shuma e sjellë nga vëllai nga shteti grek dhe e depozituar njëherazi nga prindërit në bankë. Subjekti citon se kjo ishte një shumë modeste për një njeri që ka jetuar në Greqi për 15 vjet³⁷.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmoi se nga dokumentacioni i ardhur nga shteti grek rezultoi se personi i lidhur, vëllai i subjektit ka deklaruar të ardhura, për periudhën 2002 – 2011, në vlerën totale 57.107 euro. Kjo shumë është transferuar në llogarinë e tij nga shoqëria “****” sh.p.k. para se subjekti të bëhej subjekt rivlerësimi dhe nuk ka të dhëna që subjekti ka kontribuar në krijimin e saj.

AUTOMJETE NË PRONËSI TË PERSONAVE TË LIDHUR TË SUBJEKTIT

11. Automjet në pronësi të personit të lidhur/nënës Z. H.

11.1 Nga korrespondenca me DPSHTRR-në³⁸, rezulton se në pronësi të personit të lidhur me subjektin, nëna e saj, znj. Z. H., është i regjistruar automjeti me targa AA *** (i tipit “Daimler Benz” me nr. shasie ***). Ky automjet është regjistruar në pronësi të saj në datën 17.5.2016 dhe znj. Z.H. e ka përfutur me kontratë dhurimi të datës 17.5.2016 nga djali i saj E. H.³⁹.

11.2 Z. E.H. është bërë pronar i automjetit me kontratën e shitjes të lidhur në datën 25.5.2015 midis shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e shitësit, dhe z. E. H. në cilësinë e blerësit, kundrejt vlerës 342.000 lekë. Certifikata e pronësisë së automjetit që konfirmon pronësinë e tij është lëshuar në datën 2.6.2015 dhe po në atë datë ka blerë policën e sigurimit ku rezulton pronar dhe përdorues i këtij automjeti.

11.3 Subjekti ka filluar stazhin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në nëntor të vitit 2015. Pra, ky automjet ka qenë në pronësi të familjarëve të subjektit para se të bëhej subjekt rivlerësimi.

11.4 Në policat e sigurimit të viteve pasardhëse, policëmbajtës janë shtetasit Z. dhe E. H., ku shtetasja Z. H. është pronare ndërsa shtetasi E. H. është përdorues.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se ky automjet është blerë nga personi i lidhur i subjektit (vëllai i saj) para se subjekti të bëhej subjekt rivlerësimi dhe më pas e ka shitur atë brenda familjes. Nuk ka të dhëna që subjekti ka ndikuar në krijimin e kësaj pasurie.

12. Automjet në ish-pronësi të personit të lidhur/babait Xh. H.

12.1 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit na informoi se shtetasi Xh. E. H. (babai i subjektit/person i lidhur): *“Ka pasur automjetin me targa *** (e ka pasur targën ****) dhe në përfundim ka targën ***, që e ka në pronësi shtetasi E. F. K., i tipit ‘Mercedes-Benz’ me nr. shasie ***”*⁴⁰.

12.2 Me kërkesë të Komisionit, DPSHTRR-ja na vendosi në dispozicion dosjen e këtij automjeti⁴¹, nga e cila rezultoi se z. Xh.H. (babai i subjektit) e ka blerë këtë automjet nga z. S.

³⁷Kjo çështje është trajtuar tek “Figura”.

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 10.6.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 11.6.2021).

³⁹Kontratë dhurimi nr. *** , në datat 17.5.2016 dhe 17.5.2016, notere B. P., Elbasan.

⁴⁰Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.12.2020).

⁴¹Shkresë nr. *** prot., datë 10.6.2021 (protokolluar në Komision me nr.*** prot., datë 11.6.2021).

L. në datën 18.2.2012⁴², kundrejt vlerës 400.000 lekë. Në datën 11.5.2015, z. Xh.H., ia ka shitur këtë automjet z. R.M.Sh.⁴³ kundrejt vlerës 110.000 lekë.

12.3 Nga AMF-ja⁴⁴ Qendra e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në lidhje me këtë automjet, rezulton se z. Xh.H. rezulton për herë të parë si përdorues në policën e sigurimit në datën 9.12.2008 (pronar S.L.), po kështu edhe në vitin pasardhës. Në policat e sigurimit për vitet 2010 dhe 2011 figuron vetëm z. S.L., ndërsa në policën e sigurimit datë 17.12.2012 dhe datë 20.12.2014, z. Xh. H. rezulton pronar. Në policat e sigurimit të viteve pasardhëse (pasi e ka shitur mjetin) rezultojnë pronarë të tjerë.

Vlerësimi i Komisionit

Trupa gjyqesore çmon se personi i lidhur i subjektit e ka blerë këtë automjet para se subjekti të bëhej subjekt rivlerësimi dhe nuk ka të dhëna që ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie. Po ashtu edhe shitja është bërë para se të bëhej subjekt rivlerësimi.

13. Analiza financiare për vitet 2015 – 2016

Metodologjia e kryerjes së analizës financiare

13.1 Për efekt të pasqyrit të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare është bazuar në: dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja; deklaratat e interesave pasurore private/vjetore; deklaratat *Vetting*; pyetësorët me përgjigjet e subjektit; si dhe korrespondenca e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike.

13.2 Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar, bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat *neto*, dërguar nga institucionet publike⁴⁵ për subjektin e rivlerësimit, prindërit dhe vëllain, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

13.3 Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë, sa vijon:

i) Shpenzimet e jetesës, për vitet 2015 – 2016, u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së⁴⁶. Për periudhën janar-tetor 2015 janë përfshirë në analizën financiare, shpenzime jetike për 3 veta (nëna, babai, vëllai) duke qenë se kanë qenë në një trung familjar me subjektin e rivlerësimit. Shpenzimet jetike për këtë vit për subjektin nuk janë konsideruar sepse gjatë kësaj kohe ka qenë e trajtuar me bursë. Shpenzimet jetike për të kanë filluar të llogariten prej nëntorit të vitit 2015 e në vazhdim. Ndërsa gjatë vitit 2016 janë llogaritur shpenzime jetike vetëm për subjektin e rivlerësimit meqenëse ka jetuar e vetme.

ii) Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit *TIMS*, si dhe deklaratimet e subjektit⁴⁷. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë, vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaratimet e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit, kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune, të cilat janë provuar me dokumentacion. Gjithashtu, nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit, për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar tek të afërmit dhe e ka provuar me dokumentacion deklarimin e tij. Në rastet e tjera, kur deklaratimet e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit.

iii) Shpenzimet për blerje automjetesh u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, në pyetësorët, si dhe në dokumentacionin përkatës të përcjellë me to.

⁴²Kontratë shitjeje nr. ***, datë 18.2.2021, notere F.A., Durrës.

⁴³Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 11.5.2015, noter S. L., Durrës.

⁴⁴Sistemi elektronik.

⁴⁵Shkresat nr. *** prot., datë 11.12.2020, nga ISSH-ja dhe nr. *** prot., datë 10.12.2020, nga "Raiffeisen Bank".

⁴⁶Shkresë me nr. *** prot., datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja.

⁴⁷Përgjigjet e pyetësorit standard.

iv) Gjendjen e likuiditeteve⁴⁸ në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

13.4 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklarata *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

<i>Përshkrimi</i>	nëntor 2015	2016	TOTAL
TË ARDHURA dokumentuar	29 345	971 748	1 001 093
Të ardhura nga paga pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, filluar nga nëntor 2015 deri në shkurt 2017	29 345	971 748	1 001 093
SHPENZIME	28 035	378 785	406 820
Shpenzime qeraje me afat një vjeçar për periudhën 01.01.2016-31.12.2017 me këst mujor 6,000 lekë		72 000	72 000
Shpenzime jetese	28 035	235 092	263 127
Shpenzime udhëtimi	-	71 693	71 693
PASURI	-574	-76 716	-77 290
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë	-574	-76 716	-77 290
<i>Total likuiditete</i>	497	-76 219	
Analiza dokumentuar	1 885	669 679	671 564

13.5 Trup gjykues çmon se, bazuar në analizën financiare, subjekti ka pasur mundësi të krijojë pasuritë ose/dhe të kryejë shpenzimet e deklaruara me të ardhura të ligjshme për periudhën nëntor 2015 – 2016, e cila është me vlerë pozitive.

Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë

Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij.
- iii. Pasaktësia e konstatuar në deklarinë më sipër nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut të drejtësisë.
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

34. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr*** prot., datë 31.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Semiramis Xh. Hoxholli, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 5.2.2021, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, *formulari i deklarinës është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat*

⁴⁸Shkresat: nr. *** prot., datë 17.12.2020, nga “Credins Bank”; nr. *** prot., datë 4.12.2020, nga “ProCredit Bank”; nr. *** prot., datë 10.12.2020, nga “Raiffeisen Bank”; nr. *** prot., datë 11.12.2020, nga “Fibank”.

gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës dhe për subjektin nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

35. Në konkluzion, Grupi i Punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Semiramis Xh. Hoxholli.

36. Komisioni iu drejtua edhe Prokurorisë së Përgjithshme⁴⁹ dhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁵⁰ me kërkesën për informacion në lidhje me *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve për përfshirjen e subjektit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, që cenojnë figurën e tij.

36.1 Prokuroria e Përgjithshme përcolli informacionin⁵¹ e ardhur nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, nga të cilat nuk rezultoi të jetë regjistruar apo mosfilluar procedim penal në emër të subjektit të rivlerësimit.

36.2 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sqaroi⁵² se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe në atë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk rezultoi që në ngarkim të subjektit të rivlerësimit të jetë regjistruar ndonjë procedim penal

37. Nga burime të paspecifikuara Komisioni u vu në dijeni të faktit se vëllai i subjektit, z. E. H., lindur më 12.7.1982, ka qenë i dënuar me burgim në shtetin grek, për veprën penale “trafikim të lëndëve narkotike”.

38. Objekt i kontrollit të figurës, sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, është “*verifikimi i deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës*”.

39. Sipas nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen kontrollit të figurës, me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja. Deklarata mbulon periudhën nga data 1.1.2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit.

40. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dorëzuar në Komision deklaratën për figurën, në të cilën nuk ka deklaruar kontakt të papërshtatshëm dhe përfshirjen e vëllait të saj në krimin e organizuar.

41. Duke pasur parasysh sa më lart, për efekt të vlerësimit të figurës, si një ndër elementet e procesit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi si vijon:

a) A ka pasur subjekti i rivlerësimit kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar?

b) A jemi para rastit kur subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, duke mos e deklaruar këtë fakt? A jemi para fshehjes së faktit?

42. Komisioni kreu hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të administruar të gjitha provat e nevojshme që i shërbejnë kryerjes së kësaj analize.

43. Me qëllim verifikimin e vërtetësisë së informacionit të marrë si më lart, si informacion i rëndësishëm për vlerësimin e figurës së subjektit, Komisioni kërkoi nga Ministria e Drejtësisë,

⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2020.

⁵⁰Shkresë nr.*** prot., datë 31.5.2021.

⁵¹Me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 5.3.2021).

⁵²Me shkresën nr.*** prot., datë 7.6.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.6.2021).

Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana, si dhe nga Shërbimi Informativ Shtetëror, informacion nëse ato dispononin të dhëna mbi përfshirjen në veprimtari kriminale të këtij shtetasi në shtetin grek⁵³.

44. Në pritje të verifikimeve të nevojshme nga ana e këtyre strukturave dhe të përgjigjes nga ana e tyre, nga të njëjtat burime si më lart, trupi gjykues i kërkoi subjektit⁵⁴ të qartësojë të gjitha rrethanat dhe detajet rreth dënimit penal të dhënë nga gjykata greke për vëllain e saj, në bazë të të cilit ka kryer dënimin gjatë periudhës së mësipërme, duke i kujtuar se në bazë të germës dh të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka detyrimin që të japë para Komisionit të gjithë informacionin që ka të bëjë me vlerësimin e figurës.

Qëndrimi i subjektit

45. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti u shpreh se ishte e shtangur dhe e shokuar nga përmbajtja e tij dhe se nuk ishte në dijeni të sa ishte shkruar në të. Subjekti shpreh se në dijeninë e saj vëllai nuk kishte asnjë dënim penal në ngarkim të tij, si dhe kërkoi që thirrjen e tij (vëllain) në cilësinë e dëshmitarit. Gjithashtu, kërkoi që meqenëse nuk jeton në një qytet me vëllain, t'i lihet kohë që të kontaktojë me të dhe ta pyesë në lidhje me këtë konstatim, me qëllim sqarimin e çështjes.

46. Pasi iu la koha e nevojshme, subjekti paraqiti shpjegimet⁵⁵ rreth konstatimit të Komisionit, ku parashtroi se: *“Së pari, ju bëj me dije se gjetja në kuadër të hetimit tuaj administrativ është e bazuar dhe e saktë. Rezulton, nga shpjegimet verbale të tim vëllai, z. E.H., shpjegime të cilat m'i dha pas konstatimit tuaj, se dënimi penal në ngarkim të tij në shtetin grek, ekziston.*

Më konkretisht, rezulton se është arrestuar në prill të vitit 2012 për veprën penale ‘trafikim i lëndëve narkotike’. Si është gjykuar në dy shkallë të gjyqësorit, në Greqi, me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Athinë, të datës 17.9.2014, është shpallur fajtor dhe dënuar përfundimisht me 4 vjet burg.

Sipas shpjegimeve të tim vëllai, ky vendim, dënimi me burg i është konvertuar me gjobë prej 10 euro për çdo ditë burgim. Gjithashtu, nga ky dënim, atij i është zbritur koha e paraburgimit të vuajtur prej 1 viti e dy muajsh. Për rrjedhojë, periudha e vuajtur prej tij është rreth 2 vjet e gjysmë dënim. Ka rezultuar e provuar në gjykim se nuk ka qenë përpara cilësimit juridik të veprës së trafikimit të narkotikëve, edhe pse ka nisur procedimi me të tillë akuzë. Kjo, për arsye se, si rezultat i dozave minimale me të cilat është ndaluar, Gjykata e Apelit e ka cilësuar si mbajtje në doza të vogla dhe përdorim vetjak të lëndëve narkotike dhe këto rrethana janë mbajtur parasysht në dënimin e tij.

*Sipas asaj që m'u tha nga im vëlla këto ditë, ai ka marrë pjesë aktivisht në grupet e Stacionit të Këshillimit, Programit Terapeutik, Qendrës së Trajtimit të Përdoruesve të Drogës Thivës, të cilat kryhen në Qendrën e Paraburgimit Korydallos dhe në Programin e Detoksifikimit të Programit të Këshilluar, që prej datës 16.10.2012, i cili gjithashtu vepron brenda Qendrës së Paraburgimit Korydallos. Im vëlla, gjithashtu, më rrëfeu se ka qenë i shtruar në Spitalin e Korydallos ‘***, por edhe në spitalin ‘T.’ për shkak të varësisë ndaj këtyre substancave.*

Të gjitha këto fakte, të cilat ai i mban mend mirë, sepse i ka vuajtur i vetëm dhe larg familjes, janë të dokumentuara në vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit Athinë, të datës 17.9.2014. Këto fakte dhe kjo mënyrë vuajtjeje e dënimit, referuar edhe ndihmës së programeve terapeutike brenda Qendrës së Paraburgimit që ai ka ndjekur, me qëllim detoksifikimit të tij, dëshmojnë se kursesi s'ka qenë përpara konsumimit të veprës së shitjes apo trafikimit të lëndëve narkotike, në kuptim të Kodit Penal, por ka qenë përpara konsumimit të veprës së mbajtjes dhe përdorimit vetjak në doza të vogla të tyre.

⁵³Respektivisht, shkresat nr. *** prot., datë 12.7.2021; *** prot., datë 15.6.2021; *** prot., datë 9.6.2021; *** prot., datë 9.6.2021; *** prot., datë 15.6.2021; *** prot., datë 17.6.2021.

⁵⁴Pyetësi nr. 5, dërguar me e-mail-in e datës 12.7.2021.

⁵⁵Me e-mail të datës 16.7.2021.

Së dyti, me të drejtë dhe me gjasë, nga ana juaj, mund të ngrihen dyshime mbi saktësinë e deklaramit nga ana ime në momentin e plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës Vetting në vitin 2017, lidhur me këtë fakt dhe dënim penal në ngarkim të tim vëllai.

Lidhur me këtë, sqaroj përpara jush se, në asnjë rrethanë, në asnjë moment, as unë, as prindërit e mi, nuk kemi qenë në dijeni të kësaj ngjarjeje, deri në momentin që kjo gjë na u bë me dije nga ju si Komision, ditën e hënë datë 12.7.2021, në kuadër të gjetjeve tuaja. Madje, me sinqeritet absolut, ju rrëfej se, familjarisht jemi ende të shokuar dhe të shtangur nga e gjithë kjo. Im vëlla z. E.H. e ka vuajtur gjithçka vetë dhe në heshtje, në vetmi absolute në shtetin në të cilin edhe emigronte që prej vitit 1999. Rrallë, veçanërisht festave të fundvitit, ka ardhur të na vizitojë në Shqipëri. Ndërsa ne, familjarisht, nuk kemi shkuar kurrë në Greqi dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme edhe nga përmbajtja e sistemit TIMS. Por, edhe kur ka ardhur përfundimisht në Elbasan, pranë familjes, në tetor të vitit 2014, sërish nuk na ka rrëfyer asgjë. Mendoj ka qenë sa nga zori e ndjenja e fajit, aq edhe nga fakti se ka dashur të na ruajë, të na mbrojë nga shqetësimi dhe stresi që mund t'i shkaktonte kjo ngjarje dy prindërve në moshë por edhe të sëmurë.

Sa më takon mua, në vitet kur ai e ka vuajtur këtë dënim penal, sigurisht që nuk kam ditur gjë. Kemi folur çdo fundjavë në telefon (zakonisht telefononte të shtunave, 15 vjet rresht), por në asnjë moment, nuk ma ka rrëfyer vuajtjen, varësinë e tij nga këto substanca, si dhe dënimin e tij. Jo vetëm se është tej mase i ndjeshëm si natyrë dhe tip i mbyllur e i rezervuar, por kam bindjen se nuk ka dashur të më shqetësojë në përditshmërinë time dhe në angazhimet e mia profesionale. Ju bëj me dije se në vitet kur ai e ka vuajtur këtë dënim, unë kam qenë studente e diplomuar por e papunë, prill 2012 - tetor 2013. Ndërsa pjesën tjetër kam qenë kandidate për magjistrate pranë Shkollës së Magjistraturës, respektivisht vitet tetor 2013 - tetor 2014, kur edhe është kthyer në Shqipëri. Qoftë edhe në momentin kur ka ardhur përfundimisht nga Greqia, nuk na e ka bërë me dije këtë ndodhi.

Vërtetësisht ju them se në momentin që kam plotësuar atë deklaratë mbi kontrollin e figurës në vitin 2017, nuk kam qenë në dijeni të këtij fakti. Nga ana ime nuk është bërë as fshehje, as mosdeklarim. Që të jemi përpara fshehjes, do të duhet të ketë dashje dhe dijeni, si anë subjektive. Sa kohë s'kam pasur dijeni efektive, sa kohë as mua as familjes ai nuk na e ka treguar, s'mund të quhet fshehje. Fshihet diçka që dihet dhe jo ajo që nuk mund dhe ajo që nuk kemi nga ta dimë.

Nuk do të kisha pasur arsye të mos e deklaroj këtë fakt dhe këtë dënim në ngarkim të tim vëllai, sa kohë që, jo vetëm që s'quhet kontakt i papërshtatshëm një vëlla, jo vetëm që kemi pasur thujtë vetëm kontakte telefonike 15 vjet rresht, por edhe për faktin se referuar vendimit të apelit grek, ajo për të cilën ai është dënuar nuk ka qenë krim i organizuar, në kuptimin që këtij të fundit i jepet nga neni DH i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nga pikat 8 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikës së Shqipërisë' si dhe nga neni 3 i ligjit nr. 10/192, datë 3.12.2009, 'Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë'.

Sa më lart, ky rrëfim nuk do të kishte asnjë ndikim në sferën time profesionale dhe vlerësimin e përshtatshëm të figurës sime si gjyqtare. Nuk kam pasur realisht asnjë arsye për të mos e rrëfyer këtë vepër, që tek e fundit është përgjegjësi penale individuale, vetjake, për të cilën im vëlla ka vuajtur edhe dënimin, madje edhe është rehabilituar, sipas dispozitave të Kodit Penal grek.

Ju sjell në vëmendje se pika 3, e nenit 38, të ligjit nr. 84/2016 parashikon: 'Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve, por gjithashtu çdo rrethanë lehtësuese që lidhet me çdo gjetje. Çdo vlerësim i kontrollit të figurës që nuk përmban rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese, konsiderohet i paplotë'.

Vetë mungesa ime e dijenisë për këtë fakt penal është në vetvete vetë rrethana lehtësuese që ju lus ta merrni në konsideratë. Po ashtu, vuajtja dhe dënimi i tim vëllai jashtë Shqipërie në radhë të dytë, qartazi, vërteton se s'kemi pasur nga ta dinim për sa kohë s'e kishim para syve vëllanë, por prej 15 vjetësh në emigrim dhe, së treti, mungesën e një qëllimi për mosdeklarim/fshehje nga ana ime. Në çdo rast, po ta kisha ditur dhe po të më ishte thënë, do ta kisha rrëfyer. Nuk do arrija asgjë nga mungesa e deklarimit, përkundrazi. Nuk kam pasur asnjë qëllim të mos tregohem e sinqertë me procesin Vetting”.

47. Bashkëlidhur shpjegimeve, me e-mail-in në fjalë, subjekti dërgoi në cilësinë e dëshmisë një deklaratë noteriale të vëllait të saj⁵⁶ ku ka deklaruar si vijon: *“Unë i nënshkruari E.H., deklaroj me përgjegjësi të plotë dhe me vullnetin tim të lirë, se, lidhur me dënimin tim penal në shtetin grek në vitet 2012 - 2014, familja ime, prindërit e mi dhe ime motër, nuk dinë asgjë. Unë e kam vuajtur gjithçka vetë. Lidhur me këtë përgjegjësi penale, që tek e fundit është individuale, unë e kam shlyer dënimin tim dhe madje edhe jam rehabilituar, referuar dispozitave të Kodit Penal grek. Çdo gjë që kam vuajtur dhe përjetuar, ua kam mbajtur të fshehtë familjarëve ndër vite, duke dashur t'i ruaj e të mos i stresoj.*

Gjithçka u zbulua tani si rezultat i këtij procedimi administrativ, të cilit i është nënshtruar edhe ime motër, si subjekt rivlerësimi në kuadër të procesit Vetting. Në këto kushte, është e qartë mungesa e dijenisë efektive të tyre dhe se nuk kishin nga ta merrnin vesh. Rrallë jam kthyer për festa fundviti në Shqipëri, ndërkohë që as prindërit dhe as ime motër, nuk kanë ardhur kurrë për vizitë në shtetin grek. Kjo është lehtësisht e verifikueshme nga të dhënat e sistemit TIMS.

Sa i takon sime motre, jo vetëm që nuk i kam treguar kurrë gjë, por ndër vite kemi qenë jo fort të lidhur, duke pasur parasysh periudhën time të gjatë të emigrimit 1999 - 2014 në Greqi. Jemi rritur larg njeri-tjetrit, madje edhe sot e kësaj dite, marrëdhëniet tona vëlla-motër paraqiten distante”.

48. Gjithashtu, në shpjegimet e paraqitura si më lart, subjekti deklaroi se për shkak të kohës brenda së cilës iu kërkuan shpjegimet, nuk mundi ta sigurojë vendimin e sipërcituar, por kërkoi kohë që nëse ky vendim është i nevojshëm në kuadër të këtij procedimi, ta gjejë e ta vendosë në dispozicion.

49. Komisioni i kërkoi⁵⁷ subjektit që t'i vendoste në dispozicion në një kohë sa më të shpejtë vendimet në fjalë.

50. Vendimet e gjykatës greke

50.1 Subjekti vendosi në dispozicion⁵⁸ vendimet e dy shkallëve të gjykimit në Athinë, përkthimin e tyre nga greqishtja në shqip, si dhe vërtetimet e përkthimit nga noteri për të dy vendimet, nga ku rezultoi se:

50.2 Gjykata e Apelit të Krimeve Athinë, e përbërë nga një anëtar, me vendimin nr. ***/2013, e ka shpallur z. E.H. fajtor për: *“Pa qenë i varur nga përdorimi i lëndëve narkotike që të mos ketë mundësi të rehabilitohet nga to me fuqitë e veta, me më shumë vepra ka kryer krimin e trafikimit të lëndëve narkotike”.*

50.3 Me këtë vendim, gjykata e ka dënuar me 12 vjet burg dhe gjobë në vlerën 20.000 euro. Pasi ka zbritur nga ky dënim kohën që është mbajtur në paraburgim, gjykata ka caktuar si kohë dënimi që i ka mbetur, 10 vjet.

50.4 Gjithashtu, me këtë vendim i ka hequr të drejtat politike për një periudhë 3-vjeçare, si dhe ka urdhëruar deportimin e tij nga shteti grek pas vuajtjes së dënimit që u vendos për të dhe ka detyruar të dënuarin të mos hyjë më kurrë në shtetin grek.

⁵⁶Deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.7.2021, bërë para noterit F.K., Elbasan.

⁵⁷Me e-mail datë 19.7.2021.

⁵⁸Me e-mail datë 2.8.2021.

50.5 Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda Athinë (e përbërë nga trupi gjykues prej tre gjyqtarësh), me vendimin nr. 3183/2014, ka pranuar varësinë e tij nga droga dhe ka vendosur: *“Shpall të pandehurin fajtor (si i varur nga droga) se: pasi ka fituar vesin e përdoruesit të drogës, në mënyrë që ai të mos mund ta eliminojë atë vetë, me më shumë veprime ka kryer një krim të trafikimit të drogës dhe në veçanti:*

A. Në Athinë dhe në zonën më të gjerë të Atikës, në një kohë të pasaktë, por patjetër në muajin e fundit para datës 25.4.2012 që u arrestua në datën që është brenda kësaj periudhe kohore me qëllim për të blerë kundrejt një shume të panjohur parash ose në lloj tjetër këmbimi, të ndaluar me ligj, lëndë narkotike për qëllime trafikimi dhe posaçërisht të blera nga një person i panjohur, sasi të panjohura të kokainës dhe heroinës, por patjetër një sasi kokaine me një peshë totale bruto prej 14.2 gram dhe një sasi heroine me një peshë totale bruto prej 41.7 gram, të cilën ai e posedonte për tregtim.

*B. Në G., A. më 25.4 në rrugën *** në shtëpinë e tij. Në veçanti zotëronte trembëdhjetë (13) pako najloni që përmbanin kokainë, me një peshë totale bruto prej 14.2 gram dhe tetë (8) pako najloni që përmbanin një sasi heroine, me një peshë totale bruto prej 14.7 gram”.*

50.6 Për këtë vepër për të cilin vëllai i subjektit u shpall fajtor, me këtë vendim gjykata ka vendosur: *“Dënon të pandehurin i cili u shpall fajtor me 4 vjet burg dhe shpenzimet e gjyqimit prej 600 euro, të cilat do të paguhen prej tij.*

Konverton dënimin me burgim ndaj të pandehurit me gjobë prej dhjetë (10) euro për çdo ditë burgim.

Zbret nga dënimi që iu dha të pandehurit, kohën e paraburgimit të tij nga data 25.4.2012 deri më 20.6.2013, domethënë një (1) vit, një (1) muaj dhe njëzet e pesë (25) ditë dhe

Cakton pjesën e mbetur të dënimit që duhet të vuajë në burg prej dy (2) vjetësh, dhjetë (10) muaj dhe pesë (5) ditë”.

50.7 Pasi këto vendime u dërguan në Komision nga subjekti, Ministria e Drejtësisë përcolli në Komision⁵⁹, gjithashtu, përgjigjen e autoriteteve greke të drejtësisë në lidhje me z. E.H. . Sipas këtij informacioni, me vendimin nr. ****2014, të Gjykatës Tre Anëtarëshe të Krimeve të Rënda Athinë është dënuar për veprën penale “trafikim narkotikësh, raste speciale, raste të veçanta dhe veçanërisht të veçanta për trafikimin e narkotikëve, nga një toksikoman” – *dënimi kryesor: “Dënim me burgim në total 4 vjet, i shlyer me kushte ose mbikëqyrje 10 euro/ditë (...)”.*

50.8 Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar mungesën e dijenisë mbi faktin që vëllai i saj ka qenë i përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si dhe pretendimin e saj se vepra për të cilën është dënuar i vëllai nuk është krim i organizuar, në kuptimin që këtij të fundit i jepet nga neni DH i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga ligji nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

51. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit si më lart, me të cilat subjektit iu kalua barra e provës, depozitoi në Komision shpjegime të pashoqërura me ndonjë provë, duke deklaruar dhe një herë se ishte në padijeni të këtij fakti. Konkretisht, subjekti shpjegoi se: *“E di që mund të duket e pabesueshme prej Komisionit sesi mundet që një motër të mos jetë në dijeni të një dënimi penal për vëllanë e vet. Por, ja që edhe ndodh. Ndonjëherë, familja, njerëzit e dashur dhe fort të ngushtë e marrin vesh të fundit një gjë negative lidhur me një pjesëtar të tyre. Ndodhka edhe kështu. Gjetja juaj na përballi për herë të parë me këtë situatë. Nuk kam tjetër provë përveç sinqeritetit, ndershmërisë dhe fjalës sime se nuk kam fshehur asgjë. Sikurse edhe ju kam bërë me dije në shpjegimet e mia të mëparshme, mund të fshihet vetëm diçka që dihet, dhe jo ajo që nuk dihet. Në këto kushte s’jam dhe s’mund të jem subjekt i pikës 4, të nenit DH, të Kushtetutës.*

⁵⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 3.9.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 7.9.2021).

citoj: 'Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklaramë të pasakta, ose të fshehë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën'.

Pra, vetë dispozita citon se lipset ana subjektive, dijenia dhe dashja, përpjekja për të bërë deklaramë të pasakta, si anë volutive. Unë s'kisha nga ta dija dhe aq më pak s'kisha pse ta fshehja duke qenë në dijeni të rrezikut dhe sanksionit që i vjen nga ligji më i lartë i vendit, Kushtetuta, personit dhe karrierës sime. S'mundesha, në çdo rrethanë, të fshehja një gjë me të tilla përmasa, që tek e fundit do verifikohet shumë lehtësisht nëpërmjet organeve kombëtare e ndërkombëtare. Me përgjegjshmërinë që më karakterizon si njeri, ju siguroj se nuk do ta kisha futur kurrë veten time një situatë ku të vihen në dyshim vlerat e mia si gjyqtare dhe njeri, figura ime.

Mungesa ime e dijenisë për këtë fakt penal në ngarkim të tim vëllai, është në vetvete vetë rrethana lehtësuese që ju lus ta merrni në konsideratë. Po ashtu, dënimi i tim vëllai jashtë Shqipërisë në radhë të dytë, qartazi, vërteton se s'kemi pasur nga ta dinim jo vetëm unë por e gjithë familja ime për sa kohë s'e kishim para syve njeriun tonë, por prej mbi 15 vjetësh në emigrim”.

Qëndrimi i subjektit në seancën dëgjimore

52. Në seancën dëgjimore subjekti u qëndroi të njëjtave shpjegime të dhëna më parë në lidhje me mungesën e dijenisë, të pashoqëruara me ndonjë provë, duke shpjeguar se vëllai është tip i rezervuar dhe se nuk e ka ndarë me familjen këtë vuajtje të tij. Në shpjegimet e saj, subjekti parashtrroi përsëri se: *“Nuk mund të fshehet diçka që nuk dihet. Fshehet diçka që dihet. Ne jemi juristë, të gjithë në thelb dhe e dimë që fshehja, përpjekja për fshehje siç e thërret vetë neni DH i Kushtetutës, kërkon anë volutive, përpjekja për ta fshehur ose përpjekja për të bërë deklaramë të pasakta.*

Unë jam gjyqtare, njohëse shumë e mirë e ligjit, e vlerësoj veten dhe e them këtë me plot gojë, por edhe një jurist me njohuri mesatare, teksa lexon nenin DH të Kushtetutës do arrinte të kuptonte se kjo dispozitë menjëherë passjell, në rast mosdeklarimi, shkarkimin nga detyra si masë e menjëhershme. Vallë të kem dashur këtë të keqe për veten time, kur thjesht po ta kisha ditur do ta kisha deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës në Vetting në vitin 2017? Kurrë nuk më është bërë me dije nga im vëlla, as mua as familjarëve të mi. Për herë të parë që ne u përballëm me këtë gjetje, ishte gjetja nga ana juaj. Nëse ju i referoheni dhe e-mail-eve dhe shokut që unë kam pësuar në ato momente, ka qenë data 12.7 i këtij viti..., ju më keni dërguar një e-mail, ku më keni thënë: ‘Ju lutem duhet të deklaroni kontaktin e papërshtatshëm lidhur me këtë gjë. Në shok ju kam kërkuar kohë. Si kontaktova me tim vëlla, më sqaroi që ishte e vërtetë, që e kishte vuajtur vetë, u tregua bashkëpunues dhe kjo është e vërteta e vetme. Nuk kam se ç'të fsheh sepse nuk kam pasur asnjë qëllim për të fshehur. Nuk mund të penalizoj veten time duke e njohur mirë përgjegjësinë që do më vinte nga neni DH. Tek e fundit po ta kisha ditur, me pastërti do ta kisha deklaruar, sikundër kam deklaruar çdo qindarkë të çdo gjëje që më është thënë për sa kohë që nuk më afektonte deklarimi, mosdeklarimi më afektonte po ta kisha ditur. Deklarimi nuk do sillte pasojë, do ta kisha shënuar dhe do ishte mbyllur aty. Mbase nuk do ishte bërë as objekt diskutimi sot. Këtë jua them me pastërtinë time të plotë. Më keni kaluar barrën e provës në lidhje me këtë gjë. Barrë prove tjetër përveç sinqeritetit tim nuk kam, kjo është e vërteta e vetme. Ju takon juve ta vlerësoni dhe besoj në vlerësimin tuaj të drejtë”.

52.1 Në lidhje me këtë çështje, gjatë seancës dëgjimore subjektit iu drejtuan pyetje nga anëtarë të trupit gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar.

52.2 Subjekti u pyet nga trupi gjykues se cilat ishin hapat verifikues që kishte ndërmarrë para se të plotësonte formularin e deklarimit lidhur me pastërtinë e figurës, në lidhje me gjendjen gjyqësore apo veprimtarinë e anëtarëve të familjes, meqenëse si njohëse e ligjit duhet të ishte në dijeni mbi peshën e kësaj dispozite të Kushtetutës, pra të nenit DH të saj.

52.3 Në përgjigje, subjekti shpjegoi se kjo është një ngjarje që ka ndodhur larg syve të saj, pasi vëllai kishte ikur në Greqi në vitin 1999 dhe është kthyer në vitin 2014 dhe kjo ngjarje nuk ka ndodhur në Shqipëri dhe nuk është dënuar penalisht nga institucionet shqiptare, prandaj nuk kishin si të informoheshin për këtë fakt, prandaj e ka marrë të mirëqenë pastërtinë e vëllait dhe të të gjithë anëtarëve të familjes.

52.4 Trupi gjykues e pyeti subjektin nëse pas kthimit të vëllait nga Greqia në vitin 2014 nuk kishte ngritur ndonjëherë pyetjen pse vëllai nuk ikën më në Greqi dhe subjekti sqaroi se ai u kthye sepse ashtu vendosi, pasi i mjaftuan 15 vjet në emigracion.

52.5 Vëzhguesi ndërkombëtar pyeti subjektin sa shpesh vinte vëllai në Shqipëri, sa shpesh e takonte ajo atë para dënimit të tij dhe ku ka jetuar ai pasi është kthyer nga Greqia.

52.5.1 Në përgjigje, subjekti sqaroi: *“Çdo fundvit, në mos gaboj ka ardhur, çdo fundvit për festa. Është përpjekur të vijë edhe gjatë muajit mars që neve kemi festën tonë, ditën e verës, ekskluzivisht i dedikohet Elbasanit. Mbjaj mend që përpiquej të vinte më 14 mars të çdo viti, ka pasur raste edhe që nuk ka ardhur, ka pasur dhe raste që nuk ka qenë as për dy vite në Shqipëri dhe kemi pasur vetëm kontakt telefonik gjatë kohës që nuk..., zakonisht komunikoni të shtunave. Kjo që po ju them është lehtësisht e verifikueshme edhe nga hyrje-daljet e sistemit TIMS. Është po ashtu lehtësisht e verifikueshme që as unë, as prindërit e mi nuk kemi hyrë ndonjëherë në shtetin grek për ta vizituar’.*

Në lidhje me pyetjen se ku ka jetuar vëllai pas kthimit nga Greqia, subjekti sqaroi: *“Ai edhe sot e kësaj dite banon me prindërit. Nuk ka shtëpi të vetën, nuk ka as punë të vetën, këtë e kam thënë edhe në shpjegimet drejtuar Komisionit, po shfrytëzon le të themi, shijon kohën e humbur me prindërit. Gjatë kohës që ai ishte në mungesë, isha unë prezente me prindërit dhe tani kemi ndërruar rolet tona. Ai është gjatë gjithë kohës me prindërit e mi, në Elbasan, në shtëpinë tonë të lindjes dhe unë, dihet angazhimi që kam si gjyqtare, jetoj në Tiranë tek adresa e deklaruar. Shkoj tek prindërit, sigurisht”.*

52.6 Subjekti u pyet nga vëzhguesi ndërkombëtar se kush ia kishte përgatitur vëllait të saj dokumentet ligjore të noterizuara, të marra nga Shqipëria, të cilat referohen në vendimet greke. Subjekti deklaroi: *“Në mënyrë absolute jo ne. Ka pasur avokatin e tij, nga shpjegimet e tij, avokati grek është ai që na njoftoi dhe dy vendimet penale, mbase është ai që është marrë me çdo gjë lidhur me mbrojtjen e tij para autoriteteve greke. Ne nuk kemi ditur gjë, ky është fakti”.*

52.7 Gjithashtu, subjekti u pyet se si ishte e mundur që megjithëse pas kthimit nga Greqia vëllai ishte pa punë i ka dhuruar asaj (subjektit) dhe nënës, automjetet dhe u pyet, gjithashtu, se cila është situata ekonomike e vëllait momentalisht.

52.7.1 Subjekti sqaroi që nuk ishte dhuratë, por përdorim: *“Automjeti që unë përdor sot, tip ‘Smart’, është pronë e tij, në pronësi të tij, unë e përdor, nuk është dhuratë”.* Vëzhguesi ndërkombëtar e pyeti nëse është dhurim *de facto* meqë subjekti është përdoruesja e vetme dhe nëse e njëjta gjë aplikohet edhe për prindërit e saj. Përgjigja e subjektit ishte “po”. Në lidhje me situatën ekonomike të vëllait momentalisht, subjekti sqaroi: *“Jua shpjegova që nuk ka një punë, nuk është i angazhuar me veprimtari publike, private, thjesht e ardhura e vetme deri para pak muajsh, para pandemisë (viti 2018) ka qenë qiraja që vilte nga dhënia e njësisë së shërbimit me sip. prej 45 m², që bleu si e vetmja pasuri e punësimit të tij të ndershëm, e të ardhurave të tij. Sot, në dijeninë time, nuk ka asnjë të ardhur nga kjo pasuri, asnjë lloj angazhimi, as publik, as privat”.*

52.8 Pyetjes së Komisionit nëse asaj apo prindërve i kishte ngjallur dyshime shuma e sjellë nga vëllai nga shteti grek dhe e depozituar njëherazi nga prindërit në bankë, subjekti u shpreh se është një shumë modeste për një njeri që ka jetuar në Greqi për 15 vjet dhe shtoi se: *“Ato janë pjesë e sistemit, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që janë derdhur nga punëdhënësit e tij për të. Këto janë fakte, janë prova, vijnë nga punë e ndershme. Gabimi pastaj është tjetër gjë, nuk mund përvishet e gjithë figura e tij në dy vite kur ka jetuar 15 vjet atje”.*

Vlerësimi i Komisionit

53. Në pikat 3 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, përcaktohet se: “3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. 4. [...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklaratime të pasakta ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

53.1 Në pikën 3, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: “Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6 të këtij neni dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë”.

53.2 Në funksion të kësaj analize, trupi gjykues analizoi pyetjet e parashtruara më lart: (a) A konsiderohet vëllai i subjektit person i përfshirë në krimin e organizuar?; (b) A konsiderohet ai kontakt i papërshtatshëm për subjektin?; (c) A kemi të bëjmë me deklaratim të pamjaftueshëm nga ana e subjektit në deklaratën e kontrollit të figurës?; (ç) A kemi fshehje të faktit nga ana e subjektit?

a) A konsiderohet vëllai i subjektit person i përfshirë në krimin e organizuar?

Në pikën 15, të nenit 3, të ligji nr. 84/2016 parashikohet se: “Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë [...]”.

Në veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, në të cilin referon pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, janë, ndër të tjera, edhe krimet e parashikuara në nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal.

Neni 283 i Kodit Penal parashikon si vepër penale shitjen, ofrimin për shitje, dhënien ose marrjen në çdo formë, shpërndarjen, tregtimin, transportimin, dërgimin, dorëzimin, si dhe mbajtjen, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe të farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin.

Neni 283/a i Kodit Penal parashikon si vepër penale importimin, eksportimin, tranzitimin dhe tregtimin, në kundërshtim me ligjin, të substancave narkotike ose psikotrope, si dhe të farërave të bimëve narkotike.

Vepra për të cilën është dënuar në Greqi vëllai i subjektit është “trafikimi i drogës”, një vepër penale që përfshihet në të dyja dispozitat e sipërpërmendura të Kodit Penal (nenet 283 dhe 283/a).

Trupi gjykues çmon se nuk është e nevojshme të analizojë elementet e veprës penale për të cilën është dënuar, për të përcaktuar nëse cilësimi ligjor i saj (referuar legjisllacionit shqiptar) është sipas nenit 283 apo 283/a të Kodit Penal, përderisa të dyja këto dispozita bëjnë pjesë në dispozitat ku referon baza ligjore e sipërpërmendur, për përcaktimin e personave të përfshirë në krimin e organizuar.

Pra, nga vendimet e sipërpërmendura të gjykatave, rezulton se në kuptim të përcaktimit që neni 3 i ligjit nr. 84/2016, në pikën 15 të tij bën për personat e përfshirë në krimin e organizuar, vëllai i subjektit konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar.

b) A konsiderohet ai kontakt i papërshtatshëm i subjektit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016?

Ligji nr. 84/2016, në pikën 6 të nenit 3, ka përcaktuar se: *“Kontakt i papërshtatshëm është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni, ose ndonjë marrëdhënie tjetër”*.

Subjekti ka marrëdhënie familjare me të dënuarin dhe për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, vetë ligji në shtojcën 3 të tij ka përcaktuar rrethin e personave që konsiderohen anëtarë familjeje. Sipas këtij përcaktimi, *me termin “anëtar familjeje” do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i tij, i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë, personi i lidhur me detyrime birësimi ose që bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët”*.

Në germën “ç”, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet: *“Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur: [...] ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar [...]”*.

Kjo dispozitë përcakton qartë që lidhja e ngushtë e subjektit me një person të përfshirë në krimin e organizuar është një fakt i mjaftueshëm për ta konsideruar kontakt të papërshtatshëm.

Nga sa më lart, në raport edhe me nenin 34 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se vëllai i subjektit, për efekt të ligjit nr. 84/2016, është person i përfshirë në krimin e organizuar dhe konsiderohet kontakt i papërshtatshëm i subjektit, fakt të cilin ky i fundit kishte detyrimin që ta deklaronte në deklaratën për kontrollin e figurës.

c) A kemi të bëjmë me deklaram të pamjaftueshëm nga ana e subjektit në deklaratën e kontrollit të figurës? A kemi të bëjmë me fshehje të faktit?

c.1) Sikurse analizuam më lart, neni DH i Kushtetutës përcakton detyrimin e subjektit për të plotësuar dhe dorëzuar personalisht formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, duke e plotësuar në mënyrë të saktë, të plotë dhe me vërtetësi.

c.2) Subjekti e ka plotësuar dhe dorëzuar këtë deklaratë, duke mos deklaruar dënimin e vëllait për një vepër penale të cilësuar sipas ligjit për krimin e organizuar, sikurse përcaktohet në pikat e pjesës 5, të shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016. Ndërkohë, me nënshkrimin e deklaramit, subjekti deklaronte se është i vetëdijshëm që mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaramit për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin e tij nga detyra, sipas ligjit nr. 84/2016.

c.3) Sipas pikës 6, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, rasti kur subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme, është një ndër rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është i plotë dhe i besueshëm.

c.4) Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka arsyetuar se: *“Pamjaftueshmëria e deklaramit, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të lidhet vetëm me lënien e vendeve bosh në formularin e deklaramit përkatësisht sipas kriterit, por ka të bëjë me plotësimin e formularit në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, që në momentin e vlerësimit nga grupet e kontrollit, të konkludohet në lidhje me përshtatshmërinë ose papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës⁶⁰”*.

Pra, plotësimi i formularit në mënyrë jo të saktë dhe të vërtetë konsiderohet pamjaftueshmëri e deklaramit, pra deklarimi nuk konsiderohet i plotë, prandaj trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret fakti që subjekti nuk e ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit përfshirjen e vëllait të saj në krimin e organizuar, vepër për të cilën ai është dënuar, bën që formulari i deklaramit të konsiderohet jo i plotë dhe i besueshëm.

c.5) Komisioni analizoi të gjitha shpjegimet e sipërcituara të subjektit, ku ka pretenduar se nuk kishte dijeni për këtë fakt, si dhe përgjigjet e dhëna nga subjekti në seancën dëgjimore.

⁶⁰ Pika 44.1 e vendimit nr. 2/2019 (JR), të subjektit të rivlerësimit A. Z. .

Gjithashtu, Komisioni verifikoi në sistemin *TIMS* nëse avokatët grekë të z. Hoxholli, që rezultojnë nga dy vendimet e gjykatës greke, kanë ardhur ndonjëherë në Shqipëri gjatë kohës kur ndaj tij zhvillohej hetimi dhe gjykimi⁶¹ për të përgatitur dokumentet ligjore të përdorura për mbrojtjen e tij, të referuara në vendimet e gjykatave. Nga verifikimi rezultoi që nuk është regjistruar asnjë hyrje-dalje e avokatëve në/nga Shqipëria.

54. Në përfundim, pasi analizoi të gjitha faktet si më lart, Komisioni vlerëson se vëllai i subjektit, për efekt të ligjit nr. 84/2016, është person i përfshirë në krimin e organizuar dhe konsiderohet kontakt i papërshtatshëm i subjektit, fakt të cilin subjekti kishte detyrimin ta deklaronte në deklaratën e plotësuar për kontrollin e figurës.

55. Ligji nr. 84/2016, në pikën 3 të nenit 38 përcakton se: *“Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6 të këtij neni dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë”.*

56. Në germën “d” të pikës 7 të këtij neni parashikohet që një ndër rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin, sipas të cilit formulari i deklaramit nuk është përfunduar plotësisht dhe me besueshmëri, është edhe rasti kur *subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të besueshme, parashtron se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara sipas pikës 6 të këtij neni.*

57. Bazuar në këto përcaktime ligjore, Komisioni vlerëson se mungesa e dijenisë mbi faktin e përfshirjes së vëllait në krimin e organizuar është një element i rëndësishëm për të arritur në konkluzionin nëse jemi para rastit të deklaramit të pamjaftueshëm apo të fshehjes, prandaj është e rëndësishme që ky element të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe Komisioni të krijojë bindje për vërtetësinë e tij.

58. Neni 52 i ligjit nr. 84/2016 përcakton se Komisioni, në shqyrtimin e çështjes, udhëhiqet nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit dhe nëse arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

59. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm mungesën e dijenisë mbi dënimin e vëllait dhe pavarësisht nga barra e provës subjekti nuk depozitoi asnjë provë për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, përveç shpjegimeve të saj.

60. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) vlerat monetare të përfituara nga vëllai i subjektit në Greqi, burimi i ligjshëm i të cilave nuk u provua, të depozituara në llogaritë e prindërve dhe të materializuara prej tij në pasuri (pasuri të paluajtshme, automjete), të zotëruara nga familjarët e tij; (ii) faktin që sipas shpjegimeve të subjektit kontaktet e saj me vëllain pas kthimit të tij nga Greqia kanë qenë të vazhdueshme dhe ndërkohë ai u ka bërë dhurata të konsiderueshme subjektit dhe prindërve, që janë disproporcionale me aftësitë e tij shpenzuese (duke qenë i papunë), një fakt ky i mjaftueshëm që të ngrinte dyshime mbi të ardhurat e tij; si dhe (iii) tërësinë e shpjegimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti në seancën dëgjimore ndaj pyetjeve të parashtruara nga Komisioni dhe vëzhguesi ndërkombëtar, krijoi bindjen se subjekti ka pasur informacion mbi veprimtarinë e vëllait në Greqi.

61. Me shpjegimet e parashtruara gjatë hetimit dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti nuk arriti të provonte me prova bindëse përtej çdo dyshimi të

⁶¹Sikurse është shpjeguar më sipër, në seancën dëgjimore subjekti u pyet nga vëzhguesi ndërkombëtar se kush ia kishte përgatitur vëllait të saj dokumentet ligjore të noterizuara, të marra nga Shqipëria, të cilat referohen në vendimet greke, për të cilat subjekti deklaroi se mund t'i ketë përgatitur avokati i tij.

arsyeshëm mungesën e dijenisë për përfshirjen e vëllait të saj në krimin e organizuar dhe nuk depozitoi asnjë provë për të mbështetur shpjegimet e saj.

62. Në analizë të kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kontrollin e figurës, rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka renditur në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme, në rastin konkret, vendimet e gjykatave provojnë dënimin e vëllait të subjektit për një vepër penale të përfshirë në krimin e organizuar.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar në mënyrë të besueshme dhe nuk provoi përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk ka qenë në dijeni të faktit që vëllai i saj është person i përfshirë në krimin e organizuar.
- Sipas parashtrimeve të subjektit, gjatë kohës që vëllai vuante dënimin, subjekti dhe ai kanë pasur kontakte telefonike çdo të shtunë, kontakt të cilin më parë e kishin pasur disa herë në vit kur ai vinte në Shqipëri.
- Subjekti, në funksionin e saj, në raport me detyrimin si pasojë e procesit të rivlerësimit, duhet të kishte bërë në mënyrë ezauruese të gjitha verifikimet e duhura në mënyrë që të merrte dijeni në mënyrë shteruese lidhur me të kaluarën e vëllait të saj. Pavarësisht se është i vërtetë fakti se në shtetin shqiptar nuk kishte të dhëna rreth këtij dënimi, jetesa e gjatë e tij në shtetin grek dhe transfertat e të hollave duhet të kishin detyruar subjektin të bënte verifikimet e plotë.
- Kontaktet e subjektit me vëllain pas kthimit të tij nga Greqia kanë qenë të vazhdueshme, duke kuptuar që bëhet fjalë për një marrëdhënie të ngushtë familjare dhe, përtej kësaj, subjekti kishte të drejtën e përdorimit mbi automjetin në pronësi të vëllait, për të cilin në seancën dëgjimore pranoi që ishte dhurim *de facto*. Ndërkohë, dhuratat e bëra nga vëllai subjektit dhe prindërve ishin disproporcionale me aftësitë e tij shpenzuese, duke qenë i papunë.
- Nga sistemi *TIMS* rezultoi se asnjë prej avokatëve, të cilët kanë qenë avokatë të procesit, nuk kanë ardhur asnjëherë në shtetin shqiptar, sikurse subjekti pretendoi në seancën dëgjimore.

Konkluzion përfundimtar për kontrollin e figurës

Trupi gjykues, për sa u arsyetua më lart, çmon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me kontrollin e figurës në formularin sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, duke fshehur përfshirjen e vëllait të saj në krimin e organizuar dhe referuar pikës 4, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të bëjë deklaram të pasakta ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

63. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka përgatitur raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

64. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është bazuar në: formularin e vetëdeklarimit,

tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe në të dhënat dhe dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe në të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

65. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga Komisioni u bazua në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në gjetjet e Komisionit gjatë hetimit administrativ.

Në lidhje me tri dokumentet e llojit “vendim gjyqësor”, të përzgjedhura nga subjekti

66. Subjekti i rivlerësimit ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente të llojit “vendim gjyqësor”, të cilët i përkasin vitit 2016 dhe janë një vendim penal dhe dy vendime civile.

Në të tria vendimet u konstatua që është respektuar afati standard i gjykimit.

66.1 Për njërin nga vendimet (dokumenti nr. 1) nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit që cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Në dy dokumentet e tjera u konstatua se nuk janë nënshkruar nga sekretarja gjyqësore.

66.2 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me mosnënshkrimin nga sekretarja gjyqësore, e cila shpjegoi se duke mos e pasur dosjen para e kishte të pamundur të orientohej dhe të jepte shpjegime, referuar edhe kohës së gjatë që ka kaluar. Shpjegon se në përgjithësi, me shumë pak përjashtime, është detajiste dhe se është nga ato gjyqtare që, edhe pse e re në detyrë, e sheh dhe risheh një dosje disa herë para se ta dorëzojë në sekretarinë e gjykatës. Në vijim, shprehet se: *“Pa diskutim që përgjegjësia bie mbi mua mbi çdo ekstremitet të vendimit a procesverbaleve. Duke qenë edhe dosje e përzgjedhur me dëshirën time për t’u marrë në analizë prej jush në kuadër të këtij procesi rivlerësimi, më vjen keq që një pakujdesi e tillë mund të ketë ndodhur”*.

Në lidhje me pesë dosjet e përzgjedhura me short

67. Në datën 29.5.2020, në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u përzgjedhën me short 5 dosje. Konkretisht:

- dosja nr. 1, që i përket vendimit nr. ***, datë 26.4.2016;
- dosja nr. 2, që i përket vendimit nr. ***, datë 24.5.2016;
- dosja nr. 3, që i përket vendimit nr. ***, datë 1.3.2016;
- dosja nr. 4, që i përket vendimit nr. ***, datë 20.5.2016;
- dosja nr. 5, që i përket vendimit nr. *** akti, datë 18.5.2016.

67.1 Sa i përket dosjeve nr. 1, nr. 3 dhe nr. 5, nga tërësia e veprimeve procedurale nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit, që cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

67.2 Në dosjen nr. 2 u konstatua se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtarja në kryesekretari në ditën e 13 pas shpalljes, tej afatit-10 ditor të përcaktuar në nenin 308⁶² të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, u konstatua se vetëm 2 nga 7 seancat e zhvilluara janë dokumentuar me regjistrim audio, tregues ky jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit.

⁶²Në vitin 2016, vit të cilit i përket ky vendim, sipas kësaj dispozite afati i dorëzimit në sekretari të vendimit të arsyetuar ka qenë jo më shumë se 10 ditë. Me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile të vitit 2017, ky afat u bë 20 ditë.

Qëndrimi i subjektit

67.3 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me depozitimin në sekretari të vendimit të arsyetuar tej afatit ligjor dhe për mosdokumentimin e seancave me regjistrim audio. Subjekti shpjegoi se: *“Kjo dosje ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 24.5.2016. Sakaq, është depozituar në sekretari më 6.6.2016 dhe sipas analizës së KLGJ-së është jashtë afatit 10-ditor. Ju bëj me dije se unë e kam dorëzuar dosjen më 3.6.2016, ditë e premtë. Ju me të drejtë pretendoni se si e vetmja e dhënë objektive është data e depozitimit të dosjes dhe vendimit, datë e cila gjendet e pasqyruar në regjistrat e gjykatës, porse, zakonisht, duhet marrë parasysh se kur një dosje depozitohet të hënë si ditë kalendarike, kryesekretarja ka detyrimin ta regjistrojë me datën e së premtes sepse nuk mundet t'i përfshijë si 'minus' për punën e gjyqtarit ditën e shtunë e të diel. Duke iu referuar kalendarit të vitit 2016, data e depozitimit të dosjes rezulton e hënë dhe unë pretendoj se ajo duhet të ishte regjistruar me datën e së premtes, datë 3.6.2016, sikurse edhe praktika gjyqësore e ka pranuar tanimë këtë fakt, pra brenda afatit ligjor 10-ditor nga e nesërmja e shpalljes, parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.*

Lidhur me faktin se KLGJ-ja ka konstatuar se vetëm 2 nga 7 seancat e zhvilluara janë dokumentuar me regjistrim audio, tregues ky jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit, e kundërshtoj. Së pari, lidhur me këtë padë, prej meje janë caktuar gjithsej 7 seanca (5 seanca përgatitore dhe 2 seanca gjyqësore). Është e qartë se veprimet përgatitore kanë për qëllim sqarimin e natyrës së mosmarrëveshjes, objekt gjykimi, si dhe mbledhjen e materialit provues mbi pretendimet respektive të palëve. Në këto kushte, evitohet që këto veprime të kryhen me regjistrim audio, duke i dhënë rëndësinë dhe solemnitetin e duhur atyre seancave që janë për t'u zhvilluar në fakt në audio, pra ato gjyqësore, që, sikurse del e provuar, që të dyja unë i kam të dokumentuara me këtë sistem. Ju lutem, gjithashtu të mbani parasysh se kemi qenë 8 kandidatë për stazh profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe që të gjithë, për aq sa na e ka lejuar infrastruktura e gjykatës, kemi bërë maksimumin tonë në drejtim të transparencës dhe solemnitetit të gjyqimit”.

67.4 Në dosjen nr. 4 u konstatua se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar në kryesekretari nga gjyqtarja Semiramis Hoxholli pas 10 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

67.5 Gjithashtu, u konstatua se subjekti ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, duke proceduar me gjykim të shkurtuar, por vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë pas 12 ditëve (në ditën e 13 pas depozitimit të kërkesës së prokurorit), pra jashtë afatit maksimal të 10 ditëve, të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Qëndrimi i subjektit

67.6 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me depozitimin në kryesekretari të vendimit të arsyetuar, tej afatit ligjor, si dhe në lidhje me vonesën për caktimin e seancës së parë, konkretisht për caktimin e saj jashtë afatit maksimal të 10 ditëve, të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale.

67.7 Subjekti parashtroi se: *“Gjykoj se edhe mund të ketë pasur vonesa në raste të rralla. Ky mund të jetë njëri prej tyre. Lutem të merret në konsideratë prej jush fakti se kemi qenë gjyqtarë në stazh dhe vonesa të këtij lloji me tri ditë edhe mund të kenë një marzh tolerimi”.*

67.8 Në lidhje me këtë çështje, Komisioni vlerësoi se kohëzgjatja e depozitimit të vendimit në sekretari nuk ka cenuar të drejtat e palëve në proces. Këtu mban parasysh edhe qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që me vendimin nr. 5 datë 12.12.2013, kanë disponuar se: *“[...] pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale, qofshin ato civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë dhe janë të ndërgjegjshme se jo gjithmonë këto afate mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e*

gjqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve nga ana e KLD-së. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se pamundësia për të respektuar maksimalisht këto dispozita mund të justifikohet nga ekzistenca e 33 vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, viti 2012, 29 shkaqeve objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund t'i pengojnë në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund të jenë ngarkesa e madhe në punë; kompleksiteti i çështjeve në ngarkim; sjellja e palëve gjatë procesit; pamundësia objektive e gjykatave për zhvillimin e procesit gjyqësor, shkaqe të justifikuar shëndetësore apo familjare, të cilat mund të kenë ndikim direkt tek gjyqtari dhe nuk e lejojnë të ushtrojë detyrën e tij, etj.”.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së

68. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Semiramis Hoxholli ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 9.7.2009 dhe titullin “magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2016. Pas studimeve, në datën 10.2.2017, është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku vazhdon edhe aktualisht.

69. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Semiramis Hoxholli nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së dhe sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

ANALIZA E GJETJEVE

70. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ.

Subjekti është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, si më poshtë vijon:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo njeh mirë parimet e përgjithshme të së drejtës dhe të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, duke përdorur pothuajse në të gjitha rastet referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri të mira të procedurave të gjykimit në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor. Në çështjet penale i kushton rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale, si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal dhe alternativat e tij, si dhe ka njohuri të mira edhe për masat e sigurimit penal.

Përgjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për gjyqtaren Semiramis Hoxholli nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së dhe sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme, por në disa raste përfshirja e tekstit të plotë të normave të zbatueshme i jep vendimit volum të panevojshëm. Në

arsyetim respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe i ka përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjuhë normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë kërkesat e legjislacionit procedural (civil apo penal).

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe rezulton e plotësuar me pjesë edhe nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë.

Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara që të jetë cenuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale gjyqësore, si dhe tregohet e drejta dhe afati i ankimit për palët.

Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, duke referuar në to shkakun dhe bazën ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer për 1 vit detyrën e gjyqtarës stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, njëkohësisht në dhomën civile e penale.

Ajo ka deklaruar se gjatë vitit të stazhit 2016 i janë caktuar për gjykim gjithsej 112 çështje, nga të cilat 102 çështje civile, 4 çështje penale themeli dhe 6 masa sigurimi. Ka përfunduar si kryesuese gjithsej 112 çështje, nga të cilat 102 çështje civile, 4 çështje penale themeli dhe 6 masa sigurimi. Gjithashtu, deklaroi se nga viti i fundit 2016 nuk ka pasur asnjë çështje të mbartur. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 100%.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit, përkatësisht nga data 20.11.2015 deri më 8.10.2016, gjyqtarja Semiramis Hoxholli ka përfunduar gjithsej 128 çështje gjyqësore, nga të cilat 118 çështje civile (15 civile të përgjithshme me palë kundërshtarë, 9 çështje familjare, 94 kërkesa civile) dhe 10 çështje penale (4 penale themeli e 6 masa sigurimi).

Sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtarës Semiramis Hoxholli ka qenë nën standardin minimal.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Semiramis Hoxholli ka qenë gjithnjë brenda afateve standarde apo ligjore dhe është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor.

Për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se edhe kohëzgjatja e këtyre gjykimeve ka qenë gjithnjë brenda afateve standarde apo ligjore.

Gjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj saj rezultoi se nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së dhe sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore nuk rezultoi të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në kryesekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Semiramis

Hoxholli nuk i kushton gjithmonë rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve, për të mos pasur vonesa dhe brenda afateve ligjore. Vetëm 3 prej 5 dosjeve janë dorëzuar në kryesekretari brenda afateve ligjore.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Semiramis Hoxholli ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Si stazhiere ka pasur ngarkesë sasiore nën standardin minimal, gjithmonë i ka kushtuar rëndësinë e duhur gjykimit në afat, por jo arsyetimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve.

Gjatë gjykimit ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimet përfundimtare të palëve e deri tek shpallja e vendimit.

U konstatua se në gjykimin penal të themelit vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë pas 13 ditëve, jashtë afatit maksimal të 10 ditëve, të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale, por seanca e parë është caktuar pas më shumë se 10 ditësh, siç është parashikuar nga neni 333/2 i Kodit të Procedurës Penale. Seancat gjyqësore janë caktuar gjithmonë duke respektuar afatin 15-ditor të parashikuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile (shihni dosjet 1, 2 dhe 3) ose ato penale (shihni dosjet 4 dhe 5). Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet e seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje rezultojnë se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, sipas nenit 245/a të Kodit të Procedurës Penale. Të gjitha procesverbalet rezultojnë të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe nga gjyqtarja, sipas kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në rastin e çeljes së seancës gjyqësore civile me 13 minuta vonesë, është pasqyruar në procesverbal se është dokumentuar shkaku i vonesës “problemet me audion” (shihni dosjen 1), ndërsa në rastin e çeljes së seancës gjyqësore penale me 30 minuta vonesë nuk është dokumentuar shkaku i vonesës (shihni dosjen 5).

Konstatohet se nga 19 seancat gjyqësore të pesë dosjeve të vëzhguara, kanë rezultuar të dokumentuara me regjistrim audio vetëm 8 prej tyre, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim. Trupi gjykues çmon se lidhur me këtë ka ndikuar edhe gjendja e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me numrin e pamjaftueshëm të sallave të gjykimit.

Dosjet kanë rezultuar të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e palëve ndërgjyqëse e më pas aktet e gjykatës, me përjashtim të dosjes 3 që nuk ishte sistemuar në mënyrë kronologjike. Megjithatë, të gjitha dosjet rezultojnë të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjyqtarja Semiramis Hoxholli ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 9.7.2009 dhe titullin “magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2016. Pas studimeve, në datën 10.2.2017, është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Semiramis Hoxholli nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së dhe sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtares Semiramis Hoxholli.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Semiramis Hoxholli. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Semiramis Hoxholli komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtares dhe as kërkesa të ë gjyqtares për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Semiramis Hoxholli për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 8 rastet, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli, për shkak të funksionit të gjyqtares së shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 10 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 14 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve ku ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtares së shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale.

Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli ka deklaruar se ka marrë pjesë në një aktivitet tjetër jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, në seminarin e zhvilluar në Ankara më 16-18 dhjetor 2015, me temë “*Anti-Corruption and Money Laundry*”, ku është pajisur me certifikatë.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i/e kryer nga Komisioni

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura prej saj dhe pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pas verifikimit të sa më lart, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

71. Komisioni administroi dhe mori në shqyrtim 7 denoncime të depozituara nga publiku ndaj subjektit të rivlerësimit Semiramis Hoxholli. Denoncimet ngrenë pretendime mbi shkelje të dispozitave procedurale të zhvillimit të një gjykimi të drejtë, zvarritje të procesit, vonesa në zbardhjen e vendimeve dhe vendime të padrejta.

72. Pasi shqyrtoi secilin prej denoncimeve, trupi gjykues administroi dosjet e proceseve gjyqësore, shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe regjistrimet audio për secilin prej tyre, analizoi me objektivitet dokumentacionin si më lart dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit në lidhje me këto denoncime.

1. Denoncim nr. * prot., datë 5.11.2020, i shoqërisë “****” sh.p.k.**

Denoncuesi shpjegon se ka qenë paditës në një proces gjyqësor të gjykuar nga trupi gjykues i kryesuar nga subjekti i rivlerësimit. Ai pretendon se gjatë këtij gjykimi janë kryer veprime në kundërshtim flagrant me dispozitat procedurale të zhvillimit të një gjykimi të drejtë, se gjykata ka zvarritur në mënyrë të vazhdueshme seancat përgatitore, duke i dhënë palës së paditur kundërpaditëse mundësi ekstra procedurale për të mbledhur dhe paraqitur prova në një kohë që nga pala e paditur kundërpaditëse ngriheshin pretendime konfuzë e të paqarta, pa ushtruar ndonjë të drejtë procedurale, deri në momentin që pikërisht me insistimin e gjyqtarës u depozitua më vonë edhe kundërpadia e tyre. Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur “rëzimin e padisë ...”.

Komisioni shqyrtoi dosjen gjyqësore dhe i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me kohën e arsyetimit të vendimit dhe depozitimit të tij në gjykatë, si dhe në lidhje me shtyrjet e seancave gjyqësore.

Në përfundim, Komisioni konkludoi se nga tërësia e veprimeve procedurale nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit që të kenë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të gjykimit të çështjes. Moszhvillimet e seancave kanë qenë për shkaqe të justifikuar.

U konstatua se depozitimi në sekretarinë gjyqësore i vendimit të arsyetuar është bërë në ditën e 22-të pas shpalljes së tij, pra në tejkallim të afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 42 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me depozitimin në sekretari të vendimit të arsyetuar, tej afatit ligjor. Subjekti ka shpjeguar se: *“...ka qenë dosje tej mase komplekse, ku janë gjykuar bashkë padi e kundërpadi. Ky ka qenë dhe mbetet jo vetëm për mua, porse edhe në rang gjykate, një nga proceset gjyqësore më të vështira, ku janë zhvilluar një maratonë prej 23 seancash në një hark kohor relativisht jo të gjatë prej 1 viti e 5 muaj punë. Lidhur me depozitimin me vonesë të vendimit të arsyetuar në sekretari, ju them se kjo vjen nga ngarkesa e tejskajshme që kam jo vetëm unë, por çdo gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Është fakt i njohur botërisht e s’ka nevojë të provohet ngarkesa stërmunduese që ka një gjyqtar administrativ i kryeqytetit sot. E kjo merr kuptim për më tepër në arsyetimin e këtij vendimi, ku është dashur të shqyrtohen e të merren në analizë prej nesh si trup gjykues volume të tëra provash shkresore e dokumentare”.*

2. Denoncim nr. * prot., datë 17.4.2019, i shtetasit I. Xh. B.**

Denoncuesi I.B. ka qenë person i tretë në një proces gjyqësor të gjykuar nga gjyqtarja Semiramis Hoxholli, me paditës S. Sh.(A.) dhe të paditur ZVRPP-ja Tiranë. Në këtë denoncim ai ngre pretendimet se: (i) vendimi i dhënë nga gjyqtarja është në kundërshtim me ligjin dhe me provat. Ajo i referohet vendimeve të mëparshme që nuk kanë lidhje me pronën e tij; (ii) në 35 seanca gjyqësore që ka caktuar në gjykim, vetë gjyqtarja nuk është paraqitur në 25 seanca, duke zvarritur në këtë mënyrë gjykimin, i cili më pas u mbyll me 3 seanca, pa qenë prezent pala e paditur; (iii) në dosjen gjyqësore mungonin disa dokumente të cilat janë prova thelbësore për këtë gjykim dhe që janë vendosur në dispozicion të gjykatës.

Komisioni shqyrtoi dosjen gjyqësore dhe i kërkoi subjektit⁶³ të japë shpjegime në lidhje me kohën e arsyetimit të vendimit dhe depozitimit të tij në gjykatë, si dhe në lidhje me shtyrjet e seancave gjyqësore. Subjekti paraqiti shpjegime⁶⁴ të shoqëruara me provat përkatëse, të cilat përputhen me informacionin e marrë nga gjykata. Komisioni vlerësoi se nga tërësia e veprimeve procedurale nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit që të kenë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të gjykimit të çështjes. Moszhvillimet e seancave kanë qenë për shkaqe të justifikuara.

Në lidhje me pretendimin se në dosjen gjyqësore mungonin disa dokumente të cilat janë prova thelbësore në këtë gjykim, Komisioni i kërkoi subjektit sqarime⁶⁵ nëse në këtë gjykim ka pasur dokumentacion të paraqitur nga personi i tretë, të cilin ajo nuk e ka marrë në konsideratë dhe nëse po, të japë sqarimet e nevojshme mbi dokumentin e paraqitur dhe arsyet e mospranimit të tij si provë nga ana e saj. Në përgjigje të saj, subjekti ka sqaruar se:

“Së pari, ka qenë gjykata ajo që ka konstatuar nga njohja me aktet e dosjes se interes për të qenë palë në gjykim kanë pasur edhe personat e tretë I. e S. B., duke qenë se kanë qenë kufitarë me pronën, objekt gjykimi, të paditësit S. Sh. . Për rrjedhojë, gjykata i ka thirrur kryesisht në cilësinë e personave të tretë në gjykim, duke krijuar që këtu një ndërgjyqësi të rregullt. Kjo do të thotë se ky është hapi i parë në drejtim të respektimit të së drejtës për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur me çdo mjet legjitim, si shprehje e parimit të kontradiktorialitetit dhe procesit të rregullt ligjor.

Së dyti, gjatë seancës së radhës përgatitore, të datës 18.12.2017, ora 10:30, sërish i është dhënë kohë personit të tretë dhe avokatit mbrojtës të tij të njihet me padinë dhe provat e palës paditëse e për të paraqitur kërkesë për rregullim ndërgjyqësie. Pra, del e qartë se edhe këtu parimi i kontradiktorialitetit e i së drejtës për tu mbrojtur ka gjetur shprehjen e vet maksimalisht për këta ndërgjyqës dhe seanca është caktuar në tjetër datë, po me kërkesë të tyre (provë për këtë procesverbal të seancës përgatitore të datës 18.12.2017, ora 10:30).

Së treti, rezulton se gjatë katër seancave përgatitore, realizuar në prani të palëve (referojuni ju lutem procesverbaleve [...], pjesë e dosjes gjyqësore), as nuk janë sjellë para gjykatës, paraqitur apo kërkuar trupit gjykues që të merren me cilësinë e materialit provues prova nga personi i tretë I. e S. B. . Pra, nuk rezulton gjëkund që personi i tretë të ketë paraqitur dokumentacion provues e aq më pak që gjykata të mos ia ketë pranuar apo mos marrë në shqyrtim. Madje, në seancën kur gjykata ka nxjerrë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, i ka pyetur edhe një herë palët ndërgjyqëse nëse kanë pasur apo jo prova apo kërkesa të tjera në dobi të gjykimit. Kësaj pyetjeje, personi i tretë I.B., që ka qenë i pranishëm në seancë bashkë me avokatin e tij, i është përgjigjur shprehimisht se nuk ka prova për të paraqitur dhe se është dakord për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. [...] pala e tretë I. e S. B. nuk ka paraqitur prova për gjykim as gjatë seancave përgatitore, as përpara seancës së parë gjyqësore, por as edhe gjatë seancave gjyqësore [...].

Së katërti, nga aktet, pjesë e dosjes gjyqësore, rezulton se nga personi i tretë I. B. është bërë një kërkesë drejtuar sekretarisë së gjykatës, për përjashtimin e trupit gjykues. Rezulton se kjo

⁶³Me pyetësorin nr. 3.

⁶⁴Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

⁶⁵Pyetësor nr. 3.

kërkesë është shqyrtuar nga trupa gjyqësore E. R., i cili, me vendimin e datës 9.5.2018, ka disponuar me rrëzimin e kësaj kërkesë, duke e ngarkuar edhe me gjobë personin e tretë I. B. prej 10.000 lekësh për këtë kërkesë abuzive dhe pengim e zvarritje të veprimtarisë gjyqësore”.

Pasi analizoi procesverbalet e seancave gjyqësore, regjistrimet audio të seancave dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni konkludoi që komunikimi në seancat gjyqësore është korrekt dhe me gjuhë profesionale dhe se palëve ndërgjyqëse u është dhënë mundësia që të parashtojnë pretendimet e tyre dhe të paraqesin provat që ata i gjykojnë të nevojshme.

U konstatua se depozitimi në sekretarinë gjyqësore i vendimit të arsyetuar është bërë në tejkalim të afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 42 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me depozitimin në sekretari të vendimit të arsyetuar, tej afatit ligjor.

Subjekti shpjegoi se vonesat kanë ardhur si pasojë e kompleksitetit të çështjes dhe ngarkesës me gjykime të tjera. Ajo depozitoi një kopje të kalendarit të saj personal të gjykimit, duke shpjeguar se nga data 3 dhjetor deri në 21 dhjetor (vendimi është marrë më 11.12.2018) ngarkesa e punës dhe numri i çështjeve të planifikuara për t’u gjykuar prej saj varion nga 9 apo 10 seanca minimumi, në 18 seanca maksimumi, në një ditë dhe se duke qenë e detyruar të bëjë një zgjedhje midis respektimit të afateve në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara nga njëra anë dhe arsyetimit korrekt të tyre nga ana tjetër, ka zgjedhur të dytin, duke sakrifikuar të parin.

3. Denoncim nr. * prot., datë 20.7.2018, i shtetasit A. Sh.**

Denoncuesi ka qenë punonjës i AKU-së Tiranë, i pushuar nga puna. Nga ana e punëdhënësit i është dhënë masë disiplinore, për të cilën i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Çështja është gjykuar nga gjyqtarja Semiramis Hoxholli, e cila ka rrëzuar kërkesëpadinë.

Denoncuesi pretendon se është cenuar procesi i gjykimit, pasi: së pari, nga 6 seanca gjyqësore që u bënë gjithsej, në 3 prej tyre nuk u paraqit vetë gjyqtarja dhe në të vetmen seancë hetimi gjyqësor është ndaluar të flasë, me pretendimin se foli avokati; dhe së dyti, vendimi ishte i padrejtë.

Në lidhje me pretendimin se vendimi është i padrejtë, Komisioni vlerësoi se është një pretendim që ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, e në këtë kuptim, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Në lidhje me pretendimin se është cenuar procesi i gjykimit për arsyet e sipërpërmendura, Komisioni, pasi shqyrtoi dosjen gjyqësore, shpjegimet e subjektit dhe dëgjoji regjistrimet audio të seancave, konkludoi që:

- Denoncuesit nuk i është mohuar e drejta për të qenë aktiv në debatin gjyqësor.
- Nga tërësia e veprimeve procedurale nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit që të kenë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të gjykimit të çështjes. Moszhvillimet e seancave kanë qenë për shkaqe të justifikuara.
- Depozitimi në sekretarinë gjyqësore i vendimit të arsyetuar është bërë në ditën e 23-të pas shpalljes së tij, pra, në tejkalim të afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 42 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me depozitimin në sekretari të vendimit të arsyetuar në tejkalim të afatit ligjor.

Subjekti shpjegoi se i rezulton që vendimi është marrë prej saj në datën 17.7.2018 dhe në datën 10.10.2018 është dorëzuar në kryesekretari dhe se vlen i njëjti shpjegim i parashtruar më lart për denoncimin e paraqitur nga shtetasi I. B. lidhur me ngarkesën në punë. Shton se në këtë rast ka qenë muaji gusht përpara, planifikuar si leje vjetore, ndaj dhe janë kaluar afatet. Bashkëlidhur shpjegimeve, për të treguar ngarkesën në punë, ka depozituar kopje të kalendarit të saj të planifikimit të seancave për dy javë kalendarike, 16.7.2018 – 31.7.2018.

4. Denoncim nr*prot., datë 24.7.2018, i shtetasit Th. M.**

Denoncuesi ka qenë palë paditëse në një proces gjyqësor të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, e cila, në përfundim të gjykimit, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e prova. Ndaj këtij vendimi denoncuesi ka bërë ankim.

Në denoncimin e paraqitur në Komision, denoncuesi pretendon se: (a) gjyqtarja ka zvarritur gjykimin e kësaj çështjeje, duke shtyrë seancat pa asnjë shkak; dhe (b) gjykata ka arritur në konkluzione të gabuara, haptazi në kundërshtim me ligjin.

Në lidhje me pretendimin se gjykata ka arritur në konkluzione të gabuara, në kundërshtim me ligjin, Komisioni vlerësoi se është një pretendim që ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, e në këtë kuptim, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektesinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Në lidhje me pretendimin për zvarritje të gjykimit duke shtyrë seancat pa shkak, Komisioni, pasi shqyrtoi dosjen gjyqësore, shpjegimet e subjektit dhe dëgjoi regjistrimet audio të seancave, konkludoi që nga tërësia e veprimeve procedurale nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit që të kenë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të gjykimit të çështjes. Moszhvillimet e seancave kanë qenë për shkaqe të justifikuara.

Komisioni konstatoi se depozitimi në sekretarinë gjyqësore i vendimit të arsyetuar është bërë në ditën e 36-të pas shpalljes së tij, pra, në tejkalim të afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 42 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me depozitimin në sekretari të vendimit të arsyetuar në tejkalim të afatit ligjor.

Subjekti shpjegoi se i rezulton që vendimi është marrë në datën 15.5.2018 dhe më 12.7.2018 është dorëzuar në kryesekretari. Ajo parashtroi se vlejné të njëjtat shpjegime si në rastin e mësipërm dhe për të treguar ngarkesën në punë ka depozituar kopje të kalendarit të saj të planifikimit të seancave për dy javë kalendarike, 14.5.2018 – 12.7.2018.

5. Denoncim nr. * prot., datë 6.2.2019, i shtetasit P. N. Sh.**

Denoncuesi, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “***”, ka paraqitur denoncim ndaj subjektit B. K. në lidhje me një proces gjyqësor ku ai ka qenë paditës dhe anëtare e trupit gjykues ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli.

Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur “rrëzimin e padisë”. Denoncuesi (paditësi në këtë proces) pretendon se vendimi është i padrejtë dhe absurd dhe se trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë gjyqtarja Semiramis Hoxholli, ka gjykuar pa kërkuar mendimin e një eksperti.

Komisioni konstatoi se ky denoncim ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, e në këtë kuptim vlerësohet se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektesinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

6. Denoncim nr. * prot., datë 11.9.2018, i shtetasit H.X.**

Denoncuesi ka qenë palë paditëse në një proces gjyqësor të gjykuar nga gjyqtarja Semiramis Hoxholli, e cila në përfundim të gjykimit ka vendosur rrëzimin e padisë.

Denoncuesi pretendon që:

- Vendimi i gjykatës është i padrejtë dhe jo në përputhje me ligjin dhe provat.
- Gjyqtarja ka zvarritur qëllimisht procesin gjyqësor, duke paraqitur herë pas here justifikime të llojit “*ndodhem në seminare të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës*” apo duke paraqitur raporte të paaftësisë së përkohshme në punë.
- Ka pasur vonesa edhe në zbardhjen e këtij vendimi.

Në lidhje me pretendimin se vendimi është i padrejtë, jo në përputhje me ligjin dhe provat, vërehet se ky është një pretendim që ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, e në këtë kuptim vlerësohet se, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Komisioni shqyrtoi dokumentacionin e dosjes gjyqësore, dëgjoji regjistrimet audio të seancave gjyqësore dhe analizoi shpjegimet e dërguara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe pas njohjes me rezultatet e hetimit.

Në përfundim, Komisioni konkludoi që gjykata u ka dhënë mundësi palëve të bëjnë debat gjyqësor, t’i drejtojnë pyetje njëra-tjetrës dhe të parashtrojnë para gjykatës pretendimet përfundimtare. Nga tërësia e veprimeve procedurale nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit, që të kenë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të gjykimit të çështjes. Moszhvillimet e seancave kanë qenë për shkaqe të justifikuara.

7. Denoncim nr. *prot., datë 4.5.2021, i shtetas E.S. (P.)**

Denoncuesja shpjegon se ka depozituar kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kjo çështje, me anë të shortit elektronik i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarit E.R. . Pala paditëse ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit dhe kjo kërkesë është pranuar. Denoncuesja i është drejtuar gjykatës për të kërkuar informacion, pasi, sikurse shprehet ajo, megjithëse kishin kaluar 45 ditë nga vendimi për përjashtimin e gjyqtarit, ajo nuk kishte marrë asnjë dijeni për vijimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, megjithëse në objektin e padisë është kërkuar marrja e masës së sigurimit të padisë. Në datën 13.4.2021 gjykata e ka sqaruar shkresërisht se pas pranimit të kërkesës së saj për përjashtimin e gjyqtarit, dosja është zbritur në kryesekretari dhe pas shortit elektronik i ka kaluar për shqyrtim gjyqtares Semiramis Hoxholli. Gjithashtu, ka sqaruar se sekretarja e gjyqtares e ka marrë dosjen gjyqësore në dorëzim në datën 5.3.2021 dhe rezulton se nuk ka caktuar ende datë në sistem. Denoncuesja shpjegon se në datën 21.4.2021 (sipas dëftesës së komunikimit bashkëlidhur denoncimit) është vënë në dijeni për vendimin nr. ***, datë 12.3.2021, “Për pushimin e kërkesës për marrje mase sigurimi të padisë”, të gjyqtares Semiramis Hoxholli.

Në denoncim, ankuesja ngre pikëpyetjet:

1. Përse ky vendim i marrë në datën 12.3.2021 nuk figuronte në sistemin elektronik të gjykatës deri në datën 13.4.2021?
2. Kush ka manipuluar të dhënat që duhet të ishin pasqyruar në sistemin elektronik të gjykatës, nëse ky vendim është marrë në datën 12.3.2021?

Nga vendimi bashkëlidhur denoncimit rezulton se kërkesën për sigurim padie gjyqtarja e ka shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe në fund ka vendosur pushimin e gjykimit të saj, për shkak se rezultoi që ajo është paraqitur në gjykatë edhe më parë dhe në lidhje me të gjykata ka disponuar me vendime të mëparshme.

Në pikën 3, të nenit 28, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull, kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët”*.

Komisioni, së bashku me raportin mbi rezultatet e hetimit, ia bëri të njohur këtë denoncim subjektit, dhe për aq sa ka të bëjë me detyrat e gjyqtarit, i kërkoi shpjegime në lidhje me:

- Datën e depozitimit në sekretarinë e gjykatës të vendimit të sipërpërmendur, të arsyetuar.
- Arsyen e shqyrtimit të këtij kërkimi në dhomë këshillimi, pa praninë e paditëses.

Subjekti ka sqaruar se: *“ Lidhur me pikën e parë për të cilën më kërkoni shpjegim, më rezulton se vendimi i ndërmjetëm i shqyrtimit të kërkesës për marrje mase sigurimi padie është marrë prej meje në datën 12.3.2021. Sakaq, është depozituar i arsyetuar në sekretarinë e gjykatës më 19.4.2021 dhe njoftuar denoncueses nëpërmjet shërbimit postar më 21.4.2021. Bashkëlidhur gjeni një kopje të fletës së regjistrimit të gjykatës që fakton datën e depozitimit.*

Lidhur me arsyen e shqyrtimit të këtij kërkimi, në dhomë këshillimi, pa praninë e paditëses, sikurse edhe ju e keni konstatuar kryesisht, është vetë ligji, respektivisht neni 28/3 i ligjit nr. 49/2012, që e lë në diskrecionin e gjyqtarit shqyrtimin apo jo të një kërkimi të tillë në dhomë këshillimi. Në rastin konkret, ju bëj me dije se, unë si gjykatë, kryesisht, nisur nga fakti se isha investuar disa herë me të njëjtën natyrë kërkimi, nga e njëjta kërkuese, kundrejt të njëjtës palë, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak ligjor, duhet të shmangia që e njëjta natyrë kërkese të gjykohej për së dyti, për së treti e kështu me radhë, nga i njëjti trup gjykues i së njëjtës gjykatë. Vlerësova se ky aktivitet i padobishëm i përsëritur i saj (gjykatës) duhej të evitohet. Sa më lart, bazuar në nenin 58 dhe 299/ç të Kodit të Procedurës Civile, gjykimin e kësaj kërkese e pushova në dhomë këshillimi”.

Ndër të tjera, subjekti sqaroi se ankuesja E. S. i ka të përsëritura e të shumta paditë e depozituara në gjykatën administrative, ka mbi 70 të tilla dhe se vetëm subjekti ka në gjykim 3 të tilla që ecin paralel.

Gjithashtu, sqaroi se denoncuesja i ka të përsëritura kërkesat për përjashtimin e subjektit si trup gjykues, si dhe ankesat drejtuar institucioneve për veprimtarinë e saj (të subjektit) dhe se KLD-ja ka kontrolluar dhe konfirmuar ligjshmërinë e veprimtarisë gjyqësore të subjektit në lidhje me këtë palë ndërgjyqëse dhe nuk ka gjetur shkelje disiplinore (bashkëlidhur ka vendosur vendimet e KLD-së “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasja E.S.”, përkatësisht nr. *** prot., datë 28.4.2021, dhe nr. *** prot., datë 12.5.2021, bashkë me njoftimet drejtuar shtetases E. S. dhe subjektit për dijeni).

Gjithashtu, shton se edhe kolegë të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kanë gjykuar disa herë se kërkesat e ankueses për përjashtimin e subjekti nga gjykimi i padive të saj kanë dhe kanë konkluduar se ato kanë qenë jo vetëm të pabazuara, por edhe abuzive, duke e sanksionuar edhe me gjobë në njërin rast (bashkëlidhur ka vendosur vendimet në fjalë).

Bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson.

Në lidhje me shkeljet procedurale të pretenduara në denoncimet e paraqitura, Komisioni konstatoi se gjykata ka respektuar parimin e kontradiktoritetit, duke u dhënë mundësi palëve të bëjnë debat gjyqësor, t’i drejtojnë pyetje njëra-tjetrës dhe të parashtrojnë para gjykatës pretendimet përfundimtare. Nga tërësia e veprimeve procedurale nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit, që të kenë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të gjykimit të çështjes. Moszhvillimet e seancave kanë qenë për shkaqe të justifikuara dhe vonesat në arsyetimin e vendimeve kanë ardhur si rezultat i numrit të lartë të

çështjeve në gjykim nga subjekti. Sikurse u citua më lart, Komisioni mban në konsideratë qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë se: “[...] pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale, qofshin ato civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë dhe janë të ndërgjegjshme se jo gjithmonë këto afate mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve nga ana e KLD-së. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se pamundësia për të respektuar maksimalisht këto dispozita mund të justifikohet nga ekzistenca e 33 vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, i vitit 2012, shkaqeve objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund ti pengojnë në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund të jenë ngarkesa e madhe në punë; kompleksiteti i çështjeve në ngarkim; sjellja e palëve gjatë procesit; pamundësia objektive e gjykatave për zhvillimin e procesit gjyqësor, shkaqe të justifikuara shëndetësore apo familjare, të cilat mund të kenë ndikim direkt tek gjyqtari dhe nuk e lejojnë atë të ushtrojë detyrën e tij, etj.⁶⁶”.

73. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizë të të gjitha denoncimeve, Komisioni konstatoi se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e denoncuarat për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale u konstatua se mangësitë e evidentuara nuk janë të tilla që të cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit apo që të kenë cenuar të drejtat e palëve në proces, në kuptim të pikave 3 dhe 5, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhim, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, duke respektuar të drejtat e palëve dhe ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, për këtë arsye, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli ka plotësuar së bashku kushtet, si vijon:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Semiramis Hoxholli, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

⁶⁶Vendim nr. 5, datë 12.12.2013.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, në datën 24.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta